



Republika e Kosovës- Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance



**Platforma kombëtare për mbrojtje
nga diskriminimi për komunitetet
Rom, Ashkali dhe Egjiptian**

RAPORT MBI ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

**BAZUAR NË RASTET E RAPORTUARA NË PLATFORMËN KOMBËTARE PËR
MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI**

PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Dhjetor, 2023

RAPORT MBI ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI
BAZUAR NË RASTET E RAPORTUARA NË PLATFORMËN KOMBËTARE PËR
MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI
PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Dhjetor, 2023

Shkurtesat	3
Fjala hyrëse e Drejtorit të Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim	4
1.Hyrje	5
2.Aspekti kushtetues dhe ligjor i mbrojtjes nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë	7
3.Situata e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë dhe diskriminimi ndaj tyre	9
3.1.Raportimi i rasave të diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian	15
4.Mekanizmat institucional të mbrojtjes nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian	17
4.1.Grupi teknik punës për mbrojtje nga diskriminimi për komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ne Republikën e Kosovës dhe ndërlidhja me Platformën	18
5.Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian/analizë e rasteve të adresuara	20
5.1.Analizë e rasteve të adresuara nga Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian	23
5.1.1.Rastet e raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian që kanë rezultuar me diskriminim dhe që janë adresuar në institucionet kompetente	23
5.1.2.Rastet e tjera të raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të cilat nuk kanë rezultuar me diskriminim	27
6.Ndikimi i parandalimit dhe luftimit të diskriminimit nëpërmjet Platformës Kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	31
6.1.Vlerësimi i platformës nga pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe problemet e shprehura përtej saj	33
7.Masat e ndërmarra për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	34
8.Bashkëpunimi ndër-institucional në trajtimin (menaxhimin) e rasteve të diskriminimit që janë raportuar në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian	36
9.Rastet e trajtuara nga institucionet dhe pasqyrimi i tri (3) tregimeve të suksesit	38
9.1.Rasti A.Q dhe vërtetimi i diskriminimit me aktgjykim të gjykatës	38
9.2.Rasti i SHFMU "Mati Logoreci" dhe parandalimi i diskriminimit	38
9.3.Rasti i SHFMU "Selman Riza" dhe masat e ndërmarra nga Inspektorati i Arsimit	38
10. Përfundimet dhe rekomandimet	39
SHTOJCA:PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN E PARAQITUR NË STATISTIKA	42

- 1.ANJF -Agjencia për Ndhmë Juridike Falas;
- 2.ASK-Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- 3.DUDNJ-Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- 4.Grupi Teknik-Grupi teknik punës për mbrojtje nga diskriminimi për komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës;
- 5.GJEDNJ-Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- 6.HEKS/EPER -HilfswerkDerEvangelischenKirchenDerSchweiz;
- 7.IAP-Institucioni i Avokatit të Popullit;
- 8.IKSHPK-Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës;
- 9.KEC-Qendra e Kosovës për Arsim;
- 10.KEDNJ-Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj;
- 11.KFOR-NatoKosovo Force;
- 12.KGJK-Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- 13.KKKEMKP-Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- 14.KKPK-Këshilli Konsultativ për Komunitete;
- 15.KPK-Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- 16.Kushtetuta-Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008;
- 17.LMD-Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, Nr. 05/L -021
- 18.MASHTI-Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- 19.MPB-Ministria për Punë të Brendshme;
- 20.MSH - Ministria e Shëndetësisë;
- 21.Platforma-Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian;
- 22.SwissCooperationAgency- Zyra Zvicerane për Bashkëpunim;
- 23.TdhK-TerredeshommesLaussane në Kosovë;
- 24.VoRAE-Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve;
- 25.ZQM/ZKM-Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit- Republika e Kosovës.

Fjala hyrëse e Drejtorit të Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim



Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar dhe ka prioritet parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit në përgjithësi, dhe në veçanti për grupet e cënueshme siç janë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Korniza ligjore në Kosovë është në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe fokusi kryesor i institucioneve të Kosovës është zbatimi i ligjeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe në veçanti për mbrojtjen nga diskriminimi. Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM) është një nga mekanizmat kyç dhe më të rëndësishëm në Qeverinë e Kosovës, e mandatuar me Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi konkretisht nenin 10 të këtij ligji.

Roli kyç i ZQM/ZKM është zhvillimi i politikave kundër diskriminimit, koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe në veçanti forcimi i mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi në nivelin qendror të qeverisë dhe në nivel lokal.

Duke parë rëndësinë e ndërmarrjes së veprimeve konkrete për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar mekanizma adekuat në nivel vendi. Për këtë ka themeluar mekanizmin institucional - Grupin teknik punues për mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës. Ky mekanizëm ka një përbërje të ministrive përkatëse përgjegjëse, duke përfshirë policinë dhe strukturat tjera relevante si dhe organizatat nga sektori i shoqërisë civile, dhe që ka për qëllim adresimin e ankesave nga pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, për diskriminim ndaj tyre.

Me qëllim të lehtësimit dhe përshpejtim të parandalimit dhe luftës kundër diskriminimit, në qershor të vitit 2021, Qeveria e Kosovës lansoi Platformën Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Kjo platformë është një dritare kyçe që u mundëson qytetarëve të raportojnë rastet e diskriminimit në të gjitha sferat si dhe është e qasshme dhe e lehtë për t'u përdorur për raportim nga të gjitha komunitetet, në Republikën e Kosovës.

Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe në veçanti komunitetet jo shumicë Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë e kanë rritur besimin në punën e institucioneve dhe kjo dëshmohet më së miri me faktin se, përmes platformës kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi janë trajtuar me sukses shumë raste të diskriminimit, që u janë drejtuar institucioneve përgjegjëse si policisë, gjykatave, institucionit të Avokatit të Popullit dhe departamenteve qeveritare përgjegjëse për luftimin e diskriminimit.

Në fund dua të theksoj se, ne mbetemi të përkushtuar që të punojmë çdo ditë, çdo javë, muaj dhe vit në parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit si dhe bëj thirrje për një përkushtim të përbashkët nga të gjitha institucionet në Kosovë dhe shoqëria civile.

Mos heshtni, rastet e diskriminimit duhet t'i paraqesim në platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi! Raportoni në: www.raportodiskriminimin.org

1. Hyrje

Duke u bazuar në qëllimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Nr. 05/L -021 (LMD) në bazë të kombësisë, apo lidhjes me ndonjë komunitet, zbatimi efikas i LMD është i rëndësishëm për të luftuar diskriminimin mbi baza etnike.

Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, sipas nenit 10 të LMD (Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi) ka detyrim të paraqes raport për zbatimin e LMD, me qëllim të luftimit të Diskriminimit.¹



Me qëllim të luftimit të diskriminimit, për të përmbushur qëllimin e LMD-së, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit ka marrë nismë duke krijuar Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian (Platforma), me qëllim të lehtësimit dhe përshpejtimit të parandalimit dhe luftimit kundër diskriminimit.

Me qëllim të luftimit të diskriminimit, për të përmbushur qëllimin e LMD-së, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit ka marrë nismë dhe me mbështetje të partnerëve ka krijuar Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian (Platforma). Ky raport ka për qëllim që të pasqyrojë gjendjen e diskriminimit të komuniteteve respektive, përmes rasteve të raportuara në platformë, të cilat janë adresuar nga Platforma dhe institucionet kompetente sipas LMD. Po ashtu raporti ka për qëllim të pasqyrojë zbatimin në praktikë të LMD përkitazi me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duke u bazuar në rastet që janë raportuar në Platformë si dhe trajtimin e tyre.

Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit përveç raporteve të përgjithshme për zbatimin e LMD, në këtë rast së bashku me partnerët mbështetur nga projekti «Drejtësia Sociale për Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë» që zbatohet nga Terre des hommes Laussane në Kosovë (TdhK) në partneritet me organizatën Zëri i Romëve, Ashkalive

¹ Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 10.7.

dhe Egjiptasve (VoRAE) dhe Swiss Church Aid (Swiss Cooperation Agency) dhe financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (Swiss Cooperation Agency) ka hartuar këtë raport për të pasqyruar zbatimin e LMD, në veçanti përkitazi me mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Ky raport është hartuar bazuar në të dhënat e platformës si dhe rastet e raportuara në të.

Në këtë raport, janë përfshirë të gjitha rastet e raportuara dhe të trajtuara nga platforma, që nga fillimi i punës së saj, deri në rastet e paraqitura me datë 15 Nëntor 2023.



“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”

Raporti bazohet në një metodologji gjithëpërfshirëse, që pasqyron të dhëna për diskriminimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe masat që janë ndërmarrë nga Republika e Kosovës, për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Metodologjia e këtij raporti përfshin: analizën e raporteve dhe burimeve tjera që flasin për zbatimin e LMD dhe gjendjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian; Analizimin e të dhënave për rastet e paraqitura në platformë, përfshirë edhe aspektin statistikor dhe trajtimin e tyre nga institucionet; takimi me fokus grupet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian; analizimi i çështjeve të ngritura në lidhje me zbatimin e LMD-së etj.

Në raport pasqyrohet puna e platformës në një periudhë 17 mujore, duke filluar nga Qershori 2022 deri me 15 Nëntor 2023. Raporti gjithashtu pasqyron analizën e rasteve të raportuara në platformë, së bashku me statistikatat konkrete përfshirë edhe rastet që janë trajtuar suksesshëm nga ana e platformës lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

2. Aspekti kushtetues dhe ligjor i mbrojtjes nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ju jep një mbrojtje të veçantë komuniteteve jo shumicë, si në kuadër të të drejtave të njeriut, ashtu edhe të drejtave të veçanta të garantuara enkas për komunitetet jo shumicë, përfshirë edhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.² Gjuha Rome, sipas kushtetutës e ka statusin zyrtar edhe në nivel komune.³ Neni 22 i Kushtetutës, po ashtu ka përcaktuar zbatimin e drejtpërdrejtë të instrumenteve ndërkombëtare, përfshirë Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ), Deklarata Universale të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKKEMPK) etj. Kjo nënkupton që përveç dispozitave të Kushtetutës, edhe instrumentet ndërkombëtare ofrojnë garancione shtesë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, në këtë rast atyre Rom, Ashkali dhe Egjiptian.



“Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.”

Lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi, të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duhet theksuar veçanërisht nenin 24 të Kushtetutës, i cili ndër të tjera përcakton se: “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”.⁴ Një përparësi kushtetuese për mbrojtjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, nga diskriminimi është edhe neni 53 i Kushtetutës, i cili përcakton obligimin e institucioneve publike, që të drejtat e njeriut t'i interpretojnë në harmoni me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)-së. Kushtetuta e Kosovës, gjithashtu në nenin 58 të saj përcakton se: “Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar”.⁵ Pra, ky nen paraqet detyrimin e Republikës së Kosovës, që të ndërmarrë masa që të mbrojnë komunitetet jo shumicë nga veprimet diskriminuese përfshirë edhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Edhe në kuadër të trajtimit të rasteve të raportuara në platformë, me qëllim të mbrojtjes nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, janë aplikuar me theks të veçantë, neni 24 i Kushtetutës, praktika e GJEDNJ-së dhe LMD-ja.

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kapitulli II dhe III.

³ Po aty, neni 6.2.

⁴ Po aty, neni 24.2.

⁵ Po aty, neni 58.3.

Përsa i përket LMD-së, në nenin 1 të tij, përcaktohet se qëllimi i këtij ligji është krijimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, përfshirë edhe mbi baza etnike.⁶ LMD është i zbatueshëm për kategoritë si në vijim: institucionet shtetërore dhe lokale, personat fizik dhe juridik, sektorin publik dhe privat.⁷ Duhet theksuar se në rastet e raportuara në platformë, trajtimi i tyre, në kontekst të mbrojtjes nga diskriminimi i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian është bërë duke pasur parasysh fushat që përcakton LMD në nenin 2.1 të LMD.⁸

Bazuar në rastet raportuara në platformë, është vërejtur se sipas klasifikimit të nenit 5 të LMD-së, ka pasur edhe forma të rënda të veprimeve diskriminuese ndaj pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të cilat kanë zgjatur dhe kanë pasur veçanërisht pasoja të dëmshme për palën e diskriminuar.⁹ Në të gjitha rastet e raportuara në platformë, për adresimin e tyre është aplikuar LMD si dhe mekanizmat e përcaktuar në të për të luftuar, parandaluar dhe adresuar rastet e diskriminimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Megjithatë, në rastet e raportuara në platformë, janë vërejtur situata të cilat nuk kanë rezultuar me diskriminim dhe se palët kanë pasur më shumë nevojë për ndihmë juridike, përtej mbrojtjes nga diskriminimi. Në këto raste në vend të LMD-së është dashur të aplikohen ligjet e tjera.¹⁰

Lidhur me bazën ligjore, një ligj tjetër që afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian është Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës. Në lidhje me të drejtat e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, neni 9 i Ligjit përcakton se: "Republika e Kosovës, krahas masave me synim të veçantë, zhvillon programe dhe iniciativa të tjera për punësim publik, që kanë synim të tejkalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të personave që iu përkasin komuniteteve. Konsiderim i veçantë i kushtohet përmirësimit të gjendjes së komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian".¹¹



⁶ Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 1.

⁷ Po aty, neni 2.1.

⁸ Neni 2.1 i LMD përcakton fushat si në vijim: 1.1. kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet; 1.2. qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimit përfshirë edhe përvojën e punës praktike; 1.3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës; 1.4. anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve apo në çdo organizatë tjetër anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, përfshirë edhe përfitimet që mundësohen nga organizatat e tilla; 1.5. mbrojtja sociale, përfshirë skemën e ndihmës sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore; 1.6. përparësit sociale; 1.7. lehtësitë sociale, përfshirë, por pa u kufizuar në ndihmën humanitare; 1.8. arsimin; 1.9. qasje në vendbanim, i cili është në dispozicion për publikun, si dhe qasje në forma tjera të pronës (luajtshme dhe paluajtshme; 1.10. qasje dhe furnizim në të mira materiale dhe shërbime të cilat janë në dispozicion për publikun; 1.11. trajtimi i drejtë dhe i barabartë para organeve gjyqësore dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë; 1.12. qasje dhe pjesëmarrje në shkencë, sport, art, shërbime dhe aktivitete kulturore; 1.13. sigurinë personale; 1.14. pjesëmarrjen në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur; 1.15. qasje në vendet publike, dhe 1.16. çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.

⁹ Një rast i tillë ka qenë ai i pjesëtarit të komunitetit egjiptian, A.Q, i cili është diskriminuar nga MSH, në mënyrë të vazhdueshme, për një kohë të gjatë, duke filluar nga viti 2004. Ky rast është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cnr.400/2019. 18.05.2023. Neni 5 i LMD kualifikon sqaron e rëndë të diskriminimit.

¹⁰ Raste të cilat kanë rezultuar me nevojën për ndihmë juridike dhe ku nuk ka pasur diskriminim kanë qenë ato të raportuara, nga M.K, M.B, B.B, D.I, të cilat janë adresuar nga platforma dhe nga MPB.

¹¹ Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 9.2.

3. Situata e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë dhe diskriminimi ndaj tyre

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), statistikave të popullsisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë si vijon: në popullatën e përgjithshme të Kosovës, 8,824 individë, që përbëjnë 0.5%, janë Rom, 15,436 individë, që përbëjnë 0.9%, janë Ashkali, dhe 11,524 individë, që përbëjnë 0.7% të popullsisë së përgjithshme, janë Egjiptian. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), të dhënat për numrin e popullsisë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, nga struktura e popullsisë së Kosovës, prej 8,824 ose 0,5% të popullsisë së përgjithshme janë Rom, 15,436 (që është 0,9% e popullsisë së përgjithshme) janë Ashkalinj dhe 11,524 (0,7% e popullsisë së përgjithshme) janë Egjiptian.¹²

Përsa i takon shtrirjes së popullsisë së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nëpër komuna të Kosovës, komunat ku më së shumti jetojnë pjesëtarët e këtyre komuniteteve janë: Fushë Kosova, Prizreni, Peja, Gjakova dhe Ferizaj.

Komunat me numër më të madh të banorëve, pjesëtar të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian¹³

Komuna	Rom	Ashkali	Egjiptian
Ferizaji	204	3629	24
Fushe Kosova	436	3230	282
Gjakova	738	613	5117
Prizreni	2899	1350	168
Peja	993	143	2700

Në përgjithësi, sipas statistikave të shtrirjes territoriale të popullsisë, komuniteti Rom në Kosovë jeton në zonat e komunave të Graçanicës, Pejës dhe Mitrovicës së Jugut. Komuniteti Ashkali jeton kryesisht në zonat e komunave të Ferizajt, Fushë Kosovës, Lipjanit, Prizrenit dhe Shtimes, kurse komuniteti Egjiptian në komunat e Gjakovës, Pejës, Istogut dhe Klinës.¹⁴

Lidhur me çështjen e popullsisë dhe regjistrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duhet të theksohet se për muajin prill të 2022 janë vetëm shtatë (7) komuna të cilat kanë pasur raste të regjistrimit të këtyre komuniteteve. Sipas tabelës,¹⁵ gjithsej janë 1018 persona të regjistruar. Komunat të cilat kanë pasur raste të regjistrimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë: Gjilan, Istog, Kamenicë, Mamushë, Obiliq, Rahovec dhe Viti.


¹² Raport Monitorues, "Integrimi i komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë", tetor-dhjetor 2018, Kosint 2020, f.10

¹³ Po aty, f.10-11.

¹⁴ AdaHuibregtse, "Perspektivat e të rinjve Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë Komuna e Gjakovës, Fushë Kosovës dhe Graçanicës", Organizata Ndërkombëtare e Punës 2018, f.15.

¹⁵ Shih: Të dhënat në tabelën të bazuar në: Raporti vjetor (2022) për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Zbatimi i Ligjit Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Qershor 2023, f.12.

Regjistrimi i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2022



Gjendja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, në kuptimin e diskriminimit mund të vlerësohet në fusha të ndryshme duke përfshirë: punësimin, arsimin, punësim dhe mirëqenien sociale, banimin, shëndetësinë¹⁶etj. Të gjitha këto aspekte shoqërohen edhe me diskriminim të këtyre komuniteteve në këto fusha.¹⁷

Lidhur me situatën e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në arsim, sipas të dhënave të publikuara në vitin 2018, vetëm 73 % të grave dhe 87% të meshkujve dinë shkrim-lexim. Ndërkaq në nivel të Republikës së Kosovës, raporti i pjesëmarrjes në arsim për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian është 96% në arsimin e ulët dhe 82% në arsimin e mesëm të lartë.¹⁸

Po ashtu, shkalla e vijueshmërisë së shkollimit në vitin shkollor 2019/2020, për këto komunitete kishte qenë si në vijim: Edukimi në fëmijërinë e hershme (35 – 59 muaj), 8%; Edukimi parafillor 45%; Arsimi fillor 84%; Arsimi i mesëm i ulët 64% dhe Arsimi i lartë 31%.¹⁹ Ndërkaq në vitin shkollor 2022/2023, numri i nxënësve të komunitetit Rom ka qenë 1039, i komunitetit Ashkali 3965, kurse i atyre Egjiptian ka qenë 1358.²⁰ Ndërkaq përfshirja në sistemin arsimor të nxënësve Rom, Ashkali, Egjiptian në fëmijërinë e hershme, mbetet e ulët, sipas raportit të progresit për Kosovën i vitit 2023.²¹

¹⁶ Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plan i Veprimit 2022-2024, ka identifikuar këto fusha në formë të objektivave, f.22-51.

¹⁷ Bazuar në të dhënat e platformës, ka pasur diskriminim të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në fushën e arsimit, shëndetësisë, banimit etj.

¹⁸ AdaHuibregtse, "Perspektivat e të rinjve Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë Komuna e Gjakovës, Fushë Kosovës dhe Graçanicës", Organizata Ndërkombëtare e Punës 2018, f.19-20.

¹⁹ Arsimitimi i Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Kosovë, publikoi KEC, 2021, f.25.

²⁰ Raporti për vitin 2022 mbi Zbatimin e Planit të veprimit 2022-2024 të Strategjisë për avancimin e të Drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, f.11.

²¹ Kosovo 2023 Report, Brussels, 8.11.2023, SWD(2023) 692 final, f.105.

Për të stimuluar nxënësit për shkollim të mesëm, Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) si çdo vit shkollor, edhe për vitin 2022 ka ndarë 498 bursa për nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të cilët kanë plotësuar kriteret. Shuma e ndarë gjithsej është 149.400.00 euro.²² Në vazhdimësi, çështja e pjesëmarrjes në arsim e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe pjesëmarrja e tyre në nivelet e arsimit në Kosovë është bërë duke përdorur politika stimuluese, përmes ndarjes së bursave.

Kështu, nga nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të shkollave të mesme të larta, në vitin 2019/2020, ishin 812 aplikues dhe 500 përfitues, kurse në vitin shkollor 2020/2021 ishin 700 aplikues dhe 585 përfitues.²³ Për të lehtësuar regjistrimin e studentëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, Qeveria kishte përdorur dhe vazhdon të përdor masa afirmative, duke aplikuar vende të rezervuara për pjesëtarët e këtyre komuniteteve.²⁴

Megjithatë përkundër këtij niveli të masave afirmative, braktisja shkollës në të gjitha nivelet, për pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian mbetet shqetësuese. Thënë kështu, nga viti 2017/2018 deri në vitin shkollor 2020/2021, në total 288 nxënës pjesëtar të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë braktisur mësimin.²⁵ Në kontekstin e kësaj braktisjeje, ndonëse sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, secili fëmijë me arritjen e moshës 6 vjeçare duhet të fillojë shkollimin e detyruar dhe pavarësisht që shkollimi i detyruar është përgjegjësi e prindërve, tek pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian institucionet duhet të marrin për bazë edhe aspektet e tjera që shkaktojnë këtë problem.²⁶

Gjendjen jo të mirë të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim, nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian e cilëson edhe Avokati i Popullit, në raportin e tij vjetor për vitin 2022.²⁷ “Avokati i Popullit ka vërejtur se gjithpërfshirja e nxënësve Rom, Egjiptian dhe Ashkalinj mbetet dukshëm prapa komuniteteve të tjera, veçanërisht në arsimin parashkollor dhe në atë të mesëm të lartë. Ndonëse në vitet e fundit është shënuar progres në edukimin dhe në arsimimin e fëmijëve Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian në nivel të shkollës fillore, pjesëmarrja e tyre në nivelet e tjera arsimore mbetet e ulët dhe në veçanti vërehet se pjesëmarrja e vajzave është më e ulët sesa e djemve në shkollën e mesme të lartë. Gjithashtu është vërejtur një ndarje e fushave të përzgjedhura në shkollën e mesme të lartë ku nxënësit Rom, Ashkali dhe Egjiptian detyrohen të përzgjedhin shkollat profesionale për shkak të kriterëve të rrepta të gjimnazeve”.²⁸



²² Raporti për vitin 2022 mbi Zbatimin e Planit të veprimt 2022-2024 të Strategjisë për avancimin e të Drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, f.6.

²³ Arsimimi i Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Kosovë, publikoi KEC, 2021, f.28.

²⁴ Shih: Udhëzimi Administrativ, 09/2016, Aplikimi i Masave Afirmative dhe vende të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo shumicë, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë.

²⁵ Arsimimi i Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Kosovë, publikoi KEC, 2021, f.33-34. Kjo statistikë është mbledhur në të gjitha vitet shkollore respektive.

²⁶ Përfshirja e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në vendimarrje, Analizë e Nevojave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes takimeve të hapura në Komunitat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Obiliq, Ferizaj, Gjilan, Fushë Kosovë Dhe Kamenicë, Instituti i Kosovës për Drejtësi, 20/2022, 15 dhjetor 2022, f.17.

²⁷ Raporti Vjetor për Vitin 2022 i Avokatit të Popullit, f.62.

²⁸ Po aty, f.130.

Gjendja në arsim për këto komunitete është reflektuar edhe në rastet e paraqitura në platformë, meqë një numër i theksuar i rasteve të raportuara kanë pasur të bëjnë me diskriminimin në arsim;²⁹ madje njëri nga rastet ka përfshirë një numër të madh të nxënësve të cilëve i'u është ndërprerë mësimi alternativ nga Komuna e Fushë Kosovës.³⁰

Lidhur me çështjen e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, është evidentuar që shkalla e papunësisë tek pjesëtarët e këtij komuniteti është mbi 90% dhe se ata zakonisht punojnë në sektorin informal, duke mbajtur punë të pasigurt me kualifikim të ulët.³¹ Ndërkaq lidhur me nën përfaqësimin në institucione publike të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si një faktor shihet edhe zbatimi jo efikas i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligjit për Zyrtares Publik.³²

Sipas pasqyrës së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në 2020 dhe të dhënave të zyrave komunale të punësimit, ku janë përfshirë 19 komuna, përafërsisht 1622 anëtarë të komunitetit Rom, 1609 Ashkali dhe 664 Egjiptian janë regjistruar si punë-kërkues aktivë. Sipas informatave të ofruara nga Qendrat për Punë Sociale në këto komuna, 701 familje Rome që përbëhen nga rreth 3500 individë, 1320 familje Ashkali që përbëhen nga rreth 6800 individë dhe 385 familje Egjiptiane që përbëhen nga rreth 1700 individë janë përfitues të ndihmës sociale.³³

Ndërlidhur me punësimin dhe gjendjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në takimet e mbajtura me pjesëtarë të këtyre komuniteteve, përgjatë hulumtimeve është theksuar gjendje e vështirë sociale e tyre, meqë rast të ardhurat e tyre paraqiten shumë të kufizuara, madje të pa mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet elementare edhe për një javë.³⁴ Një tjetër sfidë për pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian është edhe pamundësia e tyre që të paraqiten në tregun e punës me kontrata formale.³⁵ Për të nxitur vetëpunësimin është bërë subvencionimi në punësim afatgjatë të komuniteteve Rom dhe Ashkali në sektorin privat. Numri i përfshirë në subvencionim në pagë gjatë vitit 2022 ishte 26 persona, ku prej tyre ishin shtatë (7) Rom, dhjetë (10) Ashkali dhe nëntë (9) Egjiptian.³⁶

Lidhur me sektorin e shëndetësisë, duhet theksuar se në Strategjinë për Avancimin të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024, janë përcaktuar tri objektiva si në vijim:

1. Të përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali;
2. Të përmirësohet sjellja dhe praktikat shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali;
3. Të përmirësohet vetëdijësimi i popullsisë së komuniteteve Rom dhe Ashkali në ushqyeshmëri të shëndetshme dhe parandalimin e sëmundjeve kronike jo të transmetueshme.³⁷

²⁹ Rastet e raportuara në platformë si rasti A.M (2023); rasti SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren (2023); rasti E.K (2023), rasti i Qendrës "Përparimi".

³⁰ Rasti i SHFMU "Selman Riza", Fushë Kosovë, i raportuar në vitin 2023.

³¹ Kosovo 2023 Report, Brussels, 8.11.2023, SWD(2023) 692 final, f.100.

³² Nxitja dhe promovimi i punësimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, për arritjen e kuotës së punësimit në institucionet publike, sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës. Konzorciumi i organizatave Hilfswerker Evangelischen Kirchen Schweiz HEKS, Terredeshommes Foundation, në emër të projektit "Social Justice" të bashkëfinancuar nga The Swiss Agency for Development and Cooperation SDC, të përfaqësuara nga OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianë", Prill 2021, f.32.

³³ Analizë për identifikimin e pengesave dhe vështirësive të grupeve të cënueshme dhe komuniteteve për përfshirje në Skemën e Ndihmës Sociale, mbështetur nga TDH, 2023, f.21.

³⁴ Analizë për identifikimin e pengesave dhe vështirësive të grupeve të cënueshme dhe komuniteteve për përfshirje në Skemën e Ndihmës Sociale, mbështetur nga TDH, 2023, f.35.

³⁵ Po aty.

³⁶ Raporti për vitin 2022 mbi Zbatimin e Planit të veprimit 2022-2024 të Strategjisë për avancimin e të Drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, f.17.

³⁷ Strategjia për Avancimin të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024, f.26.

Përkundër strategjisë, gjendja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nuk pasqyrohet e mirë as në sektorin e shëndetësisë. Personat që i përkasin këtyre komuniteteve kanë qasje të kufizuara në shërbimet shëndetësore, përfshirë edhe shkallën e ulët të imunizimit të fëmijëve të tyre.³⁸ Në një hulumtim të realizuar në komunat e Fushës Kosovës, Shtimes, Obiliqit dhe Graçanicës, në lidhje me gjendjen shëndetësore të pjesëtarëve të komuniteteve, nga 574 familje të intervistuar, 336 prej tyre kishin deklaruar që nuk mund të blinin ilaçe për shërim.³⁹ Megjithatë një e arritur, që pasqyrohet në raportin për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit, për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali është identifikimi i fëmijëve të pa vaksinuar të këtyre komuniteteve. "IKSHPK ka bërë identifikimin e fëmijëve të pa vaksinuar nga komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes vizitave "derë me derë". Përmes kampanjës "derë më derë" janë vizituar 9,149 fëmijë nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Janë identifikuar si të pa vaksinuar 2,548 fëmijë (48% vajza), të cilët janë vaksinuar përmes kampanjës së vaksinimit mobil "catch-up vaccination". 458 fëmijë janë vaksinuar me vaksinën MMR".⁴⁰

Në kuadër të platformës, ka pasur raste të diskriminimit të cilat janë raportuar dhe që kanë pasur të bëjnë me diskriminimin në sektorin e shëndetësisë, respektivisht mungesën e qasjes në këto shërbime. Kështu, pjesëtari i komunitetit Rom K.K, ka raportuar rastin në platformë, me pretendimin se ndaj një pjesëtari të familjes së tij, është ushtruar dhunë dhe diskriminimin racor në Klinikën e Psikiatrisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ku pacienti kishte shkuar për të marrë trajtim mjekësor.⁴¹

Ndërkaq në një rast të raportuar në platformë dhe i cili është adresuar nga platforma, gjykata ka gjetur që Ministria e Shëndetësisë (MSH) e ka diskriminuar indirekt, pjesëtarin e komunitetit egjiptian A.Q, me që rast përmes mos nostrifikimit të certifikatës së specializimit, duke krijuar kushte të pabarabarta për të në profesion.⁴²

Përsa i përket banimit dhe gjendjes së komuniteteve, Rom, Ashkali dhe Egjiptian në këtë aspekt në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024, janë përcaktuar katër objektivat si në vijim:

1. Të identifikohen nevojat e komuniteteve Rom dhe Ashkali për banim adekuat dhe banim social dhe zvogëlohet segregimi në planifikim urban;
2. Të shtohet ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të banimit;
3. Të ofrohet mbështetje për banim adekuat dhe banim social të qëndrueshëm, dhe të buxhetuar.
4. Komunitetet Rom dhe Ashkali të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga politikat e banimit".⁴³ Lidhur me përmbushjen e këtyre objektivave, një zhvillim i rëndësishëm është draftimi i projekt ligjit për banim social përgjatë vitit 2022.⁴⁴

Çështja e vështirësive në banim dhe diskriminimi mbi bazën e zgjedhjes së banimit është adresuar edhe nga Avokati i Popullit të Kosovës, në raportin ex officio për nr.453/2018 "Mungesa e kushteve të përshtatshme për banim të komuniteteve Rom, Ashkali dhe egjiptian të kthyer nga Maqedonia e Veriut në Obiliq". Sipas këtij raporti, Avokati i Popullit ka konstatuar se mohimi i të drejtës për të zgjedhur vendbanimin, paraqet shkelje të të drejtave të njeriut, të përcaktuar me nenin 35 të Kushtetutës, legjislacionin vendor si dhe parimet udhëzuese të OKB-së për të zhvendosurit brenda vendimit.

³⁸ Kosovo 2023 Report, Brussels, 8.11.2023, SWD(2023) 692 final, f.95.

³⁹ Raport mbi gjendjen shëndetësore të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunat e Fushë Kosovës, Shtimes, Obiliqit dhe Graçanicës, BalkanSunflowers Kosova, 2020, f.11.

⁴⁰ Raporti për vitin 2022 mbi Zbatimin e Planit të veprimit 2022-2024 të Strategjisë për avancimin e të Drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, f.8.

⁴¹ Rasti i raportuar nga K.K. në vitin 2022. Megjithatë ky rast ishte shpallur i përfunduar nga platforma për shkak se nuk ishin pranuar prova nga pala për të vërtetuar pretendimet e tij, përkundër takimeve të ekipit të platformës me palën raportuese K.K.

⁴² Aktgjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë, Cnr.400/2019. 18.05.2023.

⁴³ Strategjia për Avancimin të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024, f.26.

⁴⁴ Raporti për vitin 2022 mbi Zbatimin e Planit të veprimit 2022-2024 të Strategjisë për avancimin e të Drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, f.8.

Kjo gjendje po ashtu, përbën diskriminimin për banorët e tanishëm të komunës së Obiliqit, për shkak të refuzimit të kësaj komune, me arsyetimin se të kthyerit nuk janë banorë të kësaj komune.⁴⁵ Gjithashtu, Avokati i Popullit i ka rekomanduar komunës së Obiliqit që të ndërmarrë veprime për krijimin e kushteve për kthimin e personave të zhvendosur të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, nga Maqedonia e Veriut.⁴⁶

Vlen të theksohet se sa i përket gjendjes së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, mbi bazën e ankesave të pranura gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit vëren se vazhdon të mbetet shqetësim edhe për këto komunitete zvarritja e procedurave gjyqësore për vërtetimin e të drejtave pronësore. Sfidë tjetër mbetet mosekzekutimi i aktgjykimeve të formës së prerë të gjykatave dhe i vendimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kërkesave Pronësore Banesore.⁴⁷

Po ashtu, lidhur me gjendjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duhet theksuar që komuna e Prizrenit ka zyrtarizuar gjuhën Rome si gjuhë në përdorim zyrtar.⁴⁸ Megjithatë, ky vendim ka mbetur deri tani si i tillë dhe komuna e Prizrenit nuk ka marrë ndonjë veprim tjetër për të zbatuar të njëjtin, për shkak se për të përmbushur tërësisht këtë vendim, duhet të ndryshohet Statuti i Komunës edhe pse Kushtetuta e Kosovës në nenin 6 e përcakton gjuhën Rome, si gjuhë në nivel lokal.

⁴⁵ Raporti exoficio për nr.453/2018 “Mungesa e kushteve të përshtatshme për banim të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të kthyer nga Maqedonia e Veriut në Obiliq”, paragrafi 42.

⁴⁶ Po aty, pjesa e rekomandimeve.

⁴⁷ Raporti Vjetor për Vitin 2022 i Avokatit të Popullit, f.90.

⁴⁸ Kosovo 2023 Report, Brussels, 8.11.2023, SWD (2023) 692 final, f.41.

3.1. Raportimi i rasave të diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Platforma, grupi teknik, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe partnerët mbështetës kanë inkurajuar në vazhdimësi raportimin e rasteve të diskriminimit në kuadër të platformës. Si rezultat i punës së vazhdueshme, ka pasur një rritje të ndjeshme të raportimit të rastit në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023.

Megjithatë edhe mos raportimi i rasteve të diskriminimit përbën një sfidë në vete për institucionet e Republikës së Kosovës dhe një gjë e tillë është vërejtur edhe nga rastet e raportuara në kuadër të platformës. “Për Avokatin e Popullit mbetet shqetësues fakti se raportimi i rasteve të diskriminimit mbetet akoma i vogël. Shumica e ankesave për diskriminim që paraqiten te Avokati i Popullit nuk rezultojnë me diskriminim, ndërsa rastet e vërteta të diskriminimit vazhdojnë të mos paraqiten apo denoncohen - sa nga mosnjohja e konceptit të diskriminimit, sa nga frika e viktimizimit, por edhe nga mungesa e besimit të qytetarëve te gjykatat”.⁴⁹ Avokati i Popullit, potencon dy arsye të kryesore tek mos paraqitja e rasteve të diskriminimit, që janë: 1. Frika nga viktimizimi dhe 2. Mosnjohja e konceptimit të diskriminimit.

Hezitimi i pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për të raportuar rastet e diskriminimit, vërehet edhe nga numri i ankesave të dërguara tek Avokati i Popullit, përgjatë vitit 2022, duke pasur parasysh faktin që Avokati i Popullit është njëri ndër mekanizmat kryesor të mbrojtjes nga diskriminimi. Numri i ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit për vitin 2022 është si në vijim:

1. 10 Rom;
2. 12 Ashkali;
3. 2 Egjiptian.⁵⁰

Megjithatë në raportin e Avokatit të Popullit, nuk ka të dhëna se nga 24 ankesa të paraqitura nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, sa prej tyre janë të paraqitura për diskriminimin.

Hulumtimi Kombëtar mbi Antigjipsizmin në Kosovë, i publikuar në Maj 2022, lidhur me raportimin e rasteve të diskriminimit nga pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ka gjetur se njëra ndër arsyet e hezitimit të raportimit të rasteve është mos trajtimi i duhur i tyre, nga ana e institucioneve. Po ashtu disa frikësohen që nuk kanë prova të mjaftueshme për rastin, kurse disa të tjerë nuk kanë dijeni se si të raportojnë rastin. Për këtë arsye shumica e raportuesve frikësohen të bëjnë raportimin pasi që besojnë që rasti i tyre nuk do të mund të trajtohet siç duhet.⁵¹

Edhe në kuadër të rasteve të cilat janë raportuar në platformë, është vërejtur një hezitim i raportimit të rasteve për mbrojtje nga diskriminimit, nga dhe për rastet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Argumenti për hezitimin e raportimit të rasteve në platformë lidhet me shkallën e anonimitetit të rasteve të paraqitura. Për këtë arsye, platforma shumë raste nuk ka mundur t'i adresojë në mungesë të informacioneve dhe në mungesë të personit të diskriminuar. Megjithatë duhet të inkurajohen pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që me rastin e raportimit të rasteve në platformë, të vendosin një numër të kontaktit të tyre ose kontakt tjetër, në mënyrë që të kontaktohen dhe të vendosin nëse nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet. Një gjë e tillë e mundësojnë rregullat e vendosura nga grupi teknik për platformën. Kështu nga 11 raste të paraqitura në vitin 2022 në platformë, 6 prej tyre, ose mbi 50% kanë qenë anonime. Në anën tjetër, nga 21 raste sa janë raportuar në platformë në vitin 2023, 11 prej tyre ose 50% kanë qenë të raportuara si anonime.

⁴⁹ Raporti Vjetor për Vitin 2022 i Avokatit të Popullit, f.52.

⁵⁰ Përmbledhje e raportit vjetor të Avokatit të Popullit 2022, Maj 2023, f.9.

⁵¹ Ann Morton Hyde - Dr Iulius Rostas - Drenushë Telaku - Delia Spatareanu, “National Research on Antigypsyism in Kosovo”, May 2022, f.56.

Kjo tregon gjithashtu për një gjendje të hezitimit të paraqitjes së rasteve nga ana e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duke pasur parasysh shkallën e anonimitetit të rasteve të raportuara. Raportimet anonime, mund të lidhen edhe me frikën për të raportuar hapur rastin, një konstatim ky që Avokati i Popullit e kë dhënë në raportin e vitit 2022.

Bazuar në rastet e raportuara në platformë, është vërejtur hezitim i palëve raportuese që të bashkëpunojnë për trajtimin e rasteve në institucionet kompetente, duke refuzuar që të përgjigjen ose të sjellin prova për atë që kanë pohuar me rastin e raportimit.⁵² Në bazë të analizës së stafit të platformës, ky hezitim ka ndodhur për arsyt si në vijim: 1.Mos kuptimin e palëve lidhur me konceptin e diskriminimit; 2.Mungesën e provave lidhur me rastin e paraqitur dhe ndërtimin e rastit vetëm mbi përshkrimin e ngjarjes; 3.Përzirjen e konceptit të mbrojtjes nga diskriminimi me ndihmën juridike falas dhe me ndihmën juridike që kanë nevojë këto komunitete; 4.Mos njohuritë e duhura për raportimin e rasteve.

Raportimi i rasteve në mënyrë anonime mund të cilësohet po ashtu një sfidë në raportimin e rasteve të diskriminimit, nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, e cila duhet të adresohet me kujdes nga grupi teknik, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, parterët dhe institucionet kompetente për zbatimin e LMD-së.

Bazuar në rastet e raportuara në platformë, në gjithsej 39 prej tyre, deri më 15.11.2023 dhe 41 deri më 01.12.2023, vërehet se sidomos në gjashtë muajt e fundit të vitit 2023, ka pasur një rritje intensive të raportimit të rasteve. Gjithsej 14 raste të raportuara në platformë, janë regjistruar në periudhën 1 Korrik-1 Dhjetor 2023. Kjo shifër përbën 35% të të gjitha rasteve të raportuara për 17 muaj aktivitet të platformës. Gjithashtu rritja intensive e raportimit të rasteve në periudhën Korrik-Dhjetor 2023, tregon rritjen e besimit në punën dhe angazhimin e platformës për shkak të suksesit të rasteve.



⁵² Kjo ka ndodhur në rastin e raportuar nga K.K dhe në rastin L.Q, të cilët nuk janë paraqitur për të sjellë dëshmi, për atë që kanë pohuar kur kanë raportuar rastin në Platformë.

4. Mekanizmat institucional të mbrojtjes nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Në kuptim të mekanizmave institucional për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si udhërrëfyes duhet të merret Ligji në fuqi për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr. 05/L -021 (LMD). Si mekanizma institucional për mbrojtje nga diskriminimi mbi baza etnike dhe të gjitha llojeve të tjera të diskriminimit janë: Avokati i Popullit; Gjykatat kompetente; Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit; Ministritë dhe komunat përmes zyrtarëve të caktuar për raportim të diskriminimit; Prokurori i shtetit dhe Policia e Kosovës, kur diskriminimi rezulton me vepër penale si dhe institucionet e tjera, sipas mandatit me ligje të veçanta, siç është rasti me Inspektoratin e Arsimit etj.



Grupi teknik për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian u krijua me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, si mekanizëm institucional, për të adresuar rastet dhe për të luftuar diskriminimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Ndërkaq, si mekanizma mbështetës (alternativ) për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, Rom, Ashkali dhe Egjiptian, janë: Grupi teknik i punës për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, e cila funksionon në kuadër të grupit teknik dhe administrohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, si sekretariat i grupit teknik.

4.1. Grupi teknik punës për mbrojtje nga diskriminimi për komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ne Republikën e Kosovës dhe ndërlidhja me Platformën

Grupi teknik për mbrojtje nga diskriminimi i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, u themelua me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, si mekanizëm institucional, për të adresuar rastet dhe për të luftuar diskriminimin e këtyre komuniteteve, mbi të gjitha bazat që i mundëson legjislacioni i zbatueshëm. Ndër të tjera, ky grup, mori si obligim që të adresojë të gjitha ankesat për të mbrojtur nga diskriminimi, pjesëtarët e këtyre komuniteteve.⁵³ Përveçse, në Kushtetutë dhe LMD, grupi teknik ka për qëllim që të zbatojë deklaratën e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin Romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Fushëveprimi kryesor i grupit teknik është mbrojtja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nga diskriminimi.⁵⁴ Në përbërjen e grupit teknik përfshihen përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, si përfaqësuesit e ministrive përkatëse; dy (2) përfaqësues nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit; Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK); Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKPK); Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP); Drejtori i VoRAE etj.⁵⁵ Më vonë, marrë parasysh nevojat, përbërja e grupit teknik është plotësuar dhe pjesë e takimeve të grupit teknik janë bërë edhe partnerët e tjerë, duke qenë se me vendim lejohet një gjë e tillë. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit është kryesuese e grupit teknik dhe udhëheq sekretariatit e këtij grupi.

Fushëveprimi i grupit teknik, përfshinë çështjet vijuese:

- 1. Përgjegjësinë për të zbatuar çështjet që dalin nga Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e Romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian;
- 2. Bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për të adresuar ankesat nga pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, për diskriminimin ndaj tyre;
- 3. Procedimin e ankesave kundër diskriminimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian tek institucionet kompetente;
- 4. Bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për të siguruar mbështetje ligjore, për të siguruar mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian;
- 5. Realizimin e aktiviteteve për vetëdijesimin e publikut, për të parandaluar diskriminimin ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian;
- 6. Kryerjen e aktiviteteve të tjera që kanë për qëllim adresimin e rasteve të diskriminimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.⁵⁶

Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian është duke shërbyer si mekanizëm alternativ për luftimin e diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe si mekanizëm që zbaton mandatin e Grupit Teknik, sipas vendimit të Kryeministrit për krijimin e këtij Grupi.

⁵³ Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nr.139/2020, datë 11.09.2020, pika 3.1.

⁵⁴ Po aty, pika 1.

⁵⁵ Po aty, pika

⁵⁶ Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nr.139/2020, datë 11.09.2020 pika 3.

Me qëllim të zbatimit të mandatit të tij, Grupi Teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit si sekretariat i këtij grupi, ka themeluar Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Kjo platformë është duke shërbyer si mekanizëm alternativ për luftimin e diskriminimit për këto komunitete dhe si mekanizëm që zbaton mandatin e Grupit Teknik, sipas vendimit të Kryeministrit për themelimin e këtij grupi.

Përgjatë vitit 2021, 2022, 2023, me qëllim të adresimit të çështjeve për mbrojtjen nga diskriminimi ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, grupi teknik ka mbajtur 8 (tetë) takime.⁵⁷ Grupi teknik, sipas vendimit për themelimin duhet të mbajë së paku 4 takime brenda vitit, duke përfshirë një takim në çdo 3 muaj.

Në takimet e grupit teknik përveç anëtarëve, sipas vendimit për themelimin, ftohen edhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

Me qëllim të mirë funksionimit, siç u tha më sipër punën e Grupit Teknik e organizon Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe ky grup, përfshirë edhe platforma, mbështeten nga staf profesional (ekspert dhe administrator) i cili mbështetet nga projekti “Drejtësia Sociale për Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë”. Eksperti ligjor në kuadër të grupit teknik, analizon dhe përcjell rastet që raportohen në platformë si dhe harton shkresat për adresimin e këtyre rasteve tek institucionet kompetente. Po ashtu eksperti juridik harton edhe rekomandime konkrete për grupin teknik.

Nga rastet që janë trajtuar nga ekipi profesional që mbështesin grupin teknik dhe platformën, 2 prej tyre janë raportuar në grupin teknik, kurse 5 prej tyre në Zyrën për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, gjatë vitit 2019, përderisa grupi teknik nuk ka qenë akoma i themeluar.

Që nga lansimi i Platformës, 34 raste të reja janë paraqitur direkt në platformë. Kjo tregon që Platforma ka pasur një efekt të rëndësishëm në aktivizimin e grupit teknik dhe plotësimin e përmbushjes së mandatit të tij. Pas lansimit të platformës edhe rastet e raportuara në vitin 2020 në grupin teknik dhe në vitin 2019 në Zyrën për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, janë regjistruar dhe trajtuar nga platforma dhe kjo ka rritur numrin total të rasteve në platformë në 39 raste deri më 15 Nëntor 2023 dhe 41 raste, deri më 1 dhjetor 2023.

⁵⁷ Takime të Grupit Teknik të mbajtura më: 18.05.2021; 04.08.2021; 25.11.2021; 29.03.2022; 05.09.2022; 15.12.2022; 07.02.2023; 11.07.2023

5. Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian/analizë e rasteve të adresuara

Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbështetur vlerat e përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës dhe për të luftuar diskriminimin ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Me përkushtim për të luftuar dhe parandaluar diskriminimin ndaj këtyre komuniteteve, platforma përbën një masë afirmative shtesë për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Platforma është lansuar në Qershor të vitit 2021 dhe që nga lansimi i saj, deri me 1 dhjetor 2023 janë bërë 17 muaj punë e këtij mekanizmi.

Me përkushtim për të luftuar dhe parandaluar diskriminimin ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian përbën një masë afirmative shtesë për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Menaxhuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe mbështetur nga projekti "Drejtësia Sociale për Rom, Ashkali dhe Egjiptian" që zbatohet TdhK në partneritet me organizatën VoRAE dhe HEKS/EPER dhe financohet nga Swiss Cooperation Agency, platforma ka për qëllim që t'i shërbejë grupit teknik të punës për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Grupi teknik, përmes projektit "Drejtësia Sociale", siç u tha, përveç platformës mbështetet edhe nga eksperti ligjor dhe administratorja e platformës të cilët lehtësojnë dhe mbështesin grupin teknik, e mbi të gjitha raportuesit e rasteve gjatë gjithë procesit që nga raportimi e deri tek përfundimi i rastit.⁵⁸

⁵⁸ Shih më shumë Raportin, Mbrojtja nga Diskriminimi, Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e përpjekjeve një vjeçare të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet, Rom, Ashkali dhe Egjiptian (2022-2023), versioni anglisht, f.4-5.




Tabela: Statistika të përgjithshme për Platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian lidhur me rastet e raportuara.

Që nga lansimi i saj, deri me 15 Nëntor 2023, platforma ka shënuar tërësisht 15,296 vizitorë.

Platforma operon me një mision të qartë për të pranuar dhe trajtuar rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të tërthortë, kolektiv si dhe format e tjera të diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Ajo synon të sigurojë qasje të barabartë dhe të lehtësojë raportimin e rasteve të diskriminimit, me fokus të veçantë në komunitetet e lartpërmendura Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Platforma gjithashtu luan një rol vendimtar në rritjen e ndërgjegjësimit për legjislacionin përkatës dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtjen nga diskriminimi.

Duke mbështetur vizionin e trajtimit të barabartë kushtetues dhe ligjor për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga karakteristikat e ndryshme personale, platforma përpiqet të nxisë një shoqëri pa diskriminim ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në bazë të gjinisë, moshës, statusit martesor, gjuhës, paafësisë fizike ose mendore, orientimit seksual, kombësisë, opinionit ose besimit politik, feja ose besimi, përkatësia etnike ose shoqërore, raca, pasuria, lindja ose ndonjë status tjetër.⁵⁹


⁵⁹ Po aty Shih më shumë Raportin, Mbrojtja nga Diskriminimi, Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e përpjekjeve një vjeçare të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet, Rom, Ashkali dhe Egjiptian (2022-2023), versioni anglisht, f.4-5.

Platforma shërben si një rrugë jetike për qytetarët pjesëtar të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për të raportuar rastet e diskriminimit, pavarësisht se kur dhe ku ato ndodhin. Ajo synon të promovojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve për të luftuar dhe parandaluar në mënyrë aktive dhe efektive diskriminimin ndaj këtyre komuniteteve. Përveç rolit të saj si mekanizëm raportues, platforma është një qendër informacioni gjithëpërfshirëse, që ofron përditësime mbi rastet e diskriminimit, masat parandaluese, legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen nga diskriminimi, aktivitetet e ndryshme që organizohen nga Qeveria dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe raportet vjetore. Platforma virtuale përfshin një faqe interneti, bazë të dhënash dhe aplikacionin mobil për përdoruesit, të përditësuar rregullisht me materiale politikash dhe praktike, duke përfshirë legjislacionin rajonal dhe kombëtar, procedurat operative dhe udhëzimet.⁶⁰

Përdoruesit e platformës mund të raportojnë drejtpërdrejtë rastet e diskriminimit, qoftë në lidhje me përvojat e tyre apo incidentet që kanë parë, edhe nëse nuk janë të përfshirë drejtpërdrejtë.

Ekipi i platformës punon duke u bazuar në parimin e konfidencialitetit të palëve dhe ruajtjes së fshehtësisë zyrtare, në trajtimin e rasteve të raportuara. Të gjitha rastet e raportuara shqyrtohen tërësisht nga stafi profesional dhe i referohen në mënyrë adekuate institucioneve përkatëse, në përputhje me Ligjin në fuqi për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD).⁶¹

Themelimi i platformës është përmendur edhe në raportin e progresit 2023, meqë rast, platforma vlerësohet si një mekanizëm për adresimin e rasteve të mbrojtjes nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Megjithatë, theksohet që LMD mbetet jo efektiv për luftimin e antigjipsizmit.⁶²



⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Po aty.

⁶² Kosovo 2023 Report, Brussels, 8.11.2023, SWD(2023) 692 final, f.41.

5.1. Analizë e rasteve të adresuara nga Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Përgjatë periudhës, që nga themelimi dhe deri me datë 15 Nëntor 2023, në platformë janë raportuar gjithsejtë 39 raste, të cilat mund të ndahen në dy kategori si në vijim:

1. Rastet e raportuara në platformë që kanë rezultuar me diskriminim dhe që janë adresuar në institucionet kompetente;
2. Rastet e tjera të raportuara në platformë, të cilat nuk kanë rezultuar me diskriminim.⁶³

5.1.1. Rastet e raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian që kanë rezultuar me diskriminim dhe që janë adresuar në institucionet kompetente⁶⁴

Në platformë janë gjithsej 16 raste që i përkasin kësaj kategorisë së rasteve të adresuar në institucionet kompetente, të suksesshme dhe që janë në procedurë të shqyrtimit. Prej të cilave 7 janë mbyllur me një vendim, sipas LMD, kurse 9 janë në procedurë të trajtimit nga ana e institucioneve kompetente të përcaktuara në LMD.

Dy (2) raste që nuk i përkasin kategorisë së rasteve të trajtuara, janë në trajtim e sipër.

Palët, nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian duhet të kenë parasysh të respektojnë afatet ligjore, brenda të cilave duhet dërguar rastet e diskriminimit eventual në Platformë. Kjo sepse të gjitha institucionet, sipas ligjeve të tyre aplikojnë afatet e caktuara. Kështu përshembull sipas Ligjit për Avokatin e Popullit lidhur me afatet përcaktohet si në vijim: "Avokati i Popullit nuk inicion procedurë për të hetuar shkeljen e të drejtave të njeriut nëse prej datës që pala e ka marrë vendimin e formës së prerë apo është njoftuar lidhur me të dhe deri në dorëzimin e ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë kaluar më shumë se tri (3) vite. 2. Përfshimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Avokati i Popullit mund të inicojë procedurë edhe pas kalimit të afatit prej tri (3) vite në rast se vlerëson se paraqitësi i ankesës ka qenë i penguar, në rast se shkelja është duke vazhduar, apo në rast se vlerëson se çështja është e rëndësishme së veçantë."⁶⁵ Andaj edhe me rastin e trajtimit të rasteve, platforma respekton afatet ligjore që aplikojnë institucionet përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e diskriminimit.

1. Rasti i diskriminimit kolektiv ndaj komunitetit Rom nga Obiliqi:

Lloji: Diskriminim kolektiv

Përshkrimi: Rasti përfshin komunitetin Rom nga Obiliqi, të cilët po përjetojnë diskriminim në lidhje me qasjen në banim dhe forma të tjera të pronës. Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka përgatitur një raport të veçantë dhe ia ka përcjellë Avokatit të Popullit. Aktualisht, Avokati i Popullit po trajton çështjen, e cila po monitorohet edhe nga Platforma. Ky rast është adresuar nga Avokati i Popullit sipas një raporti ex officio, të publikuar me datë 18.11.2023.

⁶³ Kjo kategori e rasteve sqarohet në seksionin e radhës 5.1.2.

⁶⁴ Rastet nga 1-8 i kësaj kategorije janë trajtuar edhe në Raportin, Mbrojtja nga Diskriminimi, Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e përpjekjeve një vjeçare të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet, Rom, Ashkali dhe Egjiptian (2022-2023), versioni anglisht, f.12-13.

⁶⁵ Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, neni 23.

2. Rasti i diskriminimit nga Policia e Kosovës ndaj një pjesëtari të komunitetit Rom:

Lloji: Diskriminim individual/pjesëmarrja në çështjet publike

Përshkrimi: Një pjesëtar i komunitetit Rom pretendon se është diskriminuar nga Policia e Kosovës, për shkak se të njëjtit nuk i është lejuar organizimi i lirisë së tubimit, në kohën e pandemisë Covid 19. Platforma ka kryer një hetim dhe ka vendosur bazat e diskriminimit. Rasti tani është duke u shqyrtuar nga Gjykata Themelore kompetente, bazuar në nenet përkatëse të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ndonëse LMD përcakton mundësi që rastet e diskriminimit të trajtohen me urgjencë nga gjykatat, që nga viti i paraqitjes së këtij rasti në gjykatë, akoma nuk ka pasur ndonjë vendim.

3. Rasti i diskriminimit ndaj një gruaje nga komuniteti Rom:

Lloji: Diskriminim individual që përbën vepër penale

Përshkrimi: Një grua nga komuniteti Rom po përballet me diskriminim mbi baza të shumta, duke përfshirë diskriminimin në bazë të veprave penale. Platforma Kombëtare ka bërë një raport të posaçëm duke theksuar diskriminimin përmes sulmit fizik (veprës penale) dhe gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale. Çështja aktualisht është në shqyrtim nga gjykatat kompetente dhe po monitorohet nga Platforma. Lidhur me këtë rast Avokati i Popullit ka nxjerrë raport me rekomandime, ku ka trajtuar me theks të veçantë aspektin e diskriminimit përmes gjuhës së urrejtjes.⁶⁶

4. Rastet e mohimit të shtetësisë për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore:

Lloji: Diskriminim i supozuar, por që u gjet si jodiskriminues

Përshkrimi: Katër qytetarë nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian pohojnë se kërkesat e tyre për shtetësi janë refuzuar për shkak të diskriminimit. Platforma Kombëtare i hetoi këto raste dhe mori përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme, duke deklaruar se mohimi nuk ishte diskriminues, por për shkak të mosplotësimit të kërkesave ligjore nga ana e aplikantëve. Rastet janë cilësuar të mbyllura.

5. Rasti i diskriminimit të vazhdueshëm nga një person fizik, që ndikon në aksesin në pronë:

Lloji: Diskriminim individual/trajtim i pabarabartë nga institucionet që administrojnë drejtësinë

Përshkrimi: Një qytetar, i cili është pjesëtar i komunitetit Rom, është i përfshirë në një rast në vazhdim që përfshin hetimin penal. Platforma është në kontakt me palën e prekur për të parandaluar diskriminimin e mëtejshëm. Diskriminimi në këtë rast i atribuohet një personi fizik dhe ka të bëjë me pengimin e ankuesit në pronë. Ky rast është adresuar tek Avokati i Popullit dhe akoma nuk ka pasur ndonjë vendim/rekomandim lidhur me këtë rast. Platforma do të vazhdojë të monitorojë dhe trajtojë këtë rast, pasi diskriminimi është i vazhdueshëm ndërsa grupi teknik do të kërkojë nga Avokati i Popullit që t'i trajtojë me prioritet këto raste. Subjekti i cili ka shkaktuar diskriminimin në këtë rast është person fizik publik përfshirë edhe Prokurorin e Shtetit.

6. Rasti i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit kolektiv i promovuar përmes rrjeteve sociale:

Lloji: Diskriminim kolektiv dhe gjuhë urrejtjeje

Përshkrimi: Një qytetar shqiptar i Republikës së Kosovës është përfshirë në gjuhë të urrejtjes përmes rrjeteve sociale, duke synuar komunitetet. Platforma e ka trajtuar këtë rast si diskriminim që përbën vepër penale. Ata kanë nisur procedurat e nevojshme dhe kanë bërë kallëzim penal pranë institucioneve kompetente.

⁶⁶ "Raport me rekomandime i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës", Exofficio Nr.468/2019, Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë, 9 dhjetor 2019.

7. Rasti i diskriminimit në arsimin e lartë:

Lloji: Diskriminim individual/diskriminim në fushën e arsimit

Përshkrimi: Një qytetare pjesëtare e komunitetit Romë shtë përballur me diskriminim lidhur me arsimin e lartë. Platforma ka pranuar përgjigje nga Institucioni (Universiteti), i përfshirë në këtë rast. Në përgjigjen e tyre janë dhënë sqarime për procedurën e regjistrimit të saj në Universitet dhe institucioni ka sqaruar arsyen ligjore të mos regjistrimit të saj.

8. Rasti i diskriminimit të vazhdueshëm në punësim nga Ministria e Shëndetësisë:

Lloji: Diskriminim individual/diskriminim i vazhdueshëm dhe trajtim jo i barabartë

Përshkrimi: Një qytetar nga komuniteti Egjiptian ka raportuar diskriminim të vazhdueshëm në punësim nga Ministria e Shëndetësisë. Platforma ka analizuar dhe trajtuar rastin për të adresuar çështjet e diskriminimit. Rasti është adresuar me sukses dhe ka përfunduar me Aktgjykim të Gjykatës Themelore Cnr.400/2019. 18.05.2023, e cila ka vërtetuar diskriminimin indirekt të MSH. Aktgjykimi i Gjykatës konstaton diskriminim indirekt të të njëjtit, për shkak të mos ofrimit të mundësive të barabarta të tij për punësim.⁶⁷

9. Rasti i gjuhës së urrejtjes me rastin e festimit të ditës së komunitetit Egjiptian:

Lloji: Diskriminim individual/gjuhë e urrejtës

Përshkrimi: Një qytetar shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, përmes postimit në faqen zyrtare në facebook të Kryeministrit të Kosovës, është përfshirë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe shprehjes së mos durimit ndaj pjesëtarëve të komunitetit egjiptian. Rasti është adresuar në organet kompetente si diskriminim që përbën vepër penale. Platforma nuk është informuar për ndonjë rezultat sa i përket këtij rasti.

10. Diskriminimi i 25 fëmijëve Rom dhe Ashkali në nga komuna e Fushë Kosovës dhe mohimi i të drejtës në arsim:

Lloji: Diskriminim kolektiv/qasje e pabarabartë në fushën e arsimit

Përshkrimi: 25 fëmijëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali ju është mohuar vazhdimi i mësimin alternativ nga një shkollë në komunën e Fushë Kosovës. Rasti ka ndodhur në vitin 2021 dhe është adresuar nga platforma në vitin 2023, pas raportimit nga TdhK, pasi që vetë TdhK, ka mbështetur mësimin alternativ të këtyre fëmijëve, në shkollën "Selman Riza" në Fushë Kosovë. Rasti është adresuar në Inspektoratin e Arsimit dhe tek Avokati i Popullit dhe platforma është duke e monitoruar në vazhdimësi këtë rast. Nga Inspektorati i Arsimit nuk është marrë asnjë përgjigje, kurse Avokati i Popullit e ka regjistruar këtë rast në prill të vitit 2023.

11. Diskriminimi i fëmijëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në një shkollë në komunën e Prizrenit:

Lloji: Diskriminim kolektiv/Parandalim i diskriminimit

Përshkrimi: Rasti është raportuar në platformë në vitin 2023 si dhe është shfaqur publikisht nga gazeta Nacionale. Sipas rrethanave të rastit, u raportuara se një shkollë në Prizren ka bërë ndarje të nxënësve në klasa sipas përkatësisë etnike. Platforma e ka adresuar rastin dhe janë marrë masa të menjëhershme nga Drejtoria Komunale në Prizren, duke parandaluar diskriminimin.

⁶⁷ Ky rast sqarohet edhe në pjesën e mëposhtme, si rast i platformës i cili ka rezultuar me sukses.

12. Diskriminimi i nxënësve nga një shkollë në komunën e Fushë Kosovës:

Lloji: Diskriminim individual/Parandalim i diskriminimit

Përshkrimi: Rasti është raportuar në komunën e Fushë Kosovës, ku nga një shkollë fillore të kësaj komune, një nxënëse të klasës së VI i është mohuar vazhdimi i shkollimit nga ana e drejtorit të shkollës, me arsyetimin e përsëritjes së vitit shkollor. Rasti, me pëlqimin e prindërve, është adresuar në Inspektoratin e Arsimit dhe platforma ka marrë përgjigje dhe inspektorati ka rekomanduar masë disiplinore ndaj drejtorit të shkollës si dhe është adresuar me sukses.

13. Diskriminimi i dy nxënësve të komuniteteve Rom, me aftësi të kufizuara:

Lloji: Diskriminim individual/Diskriminim në arsim

Përshkrimi: Dy nxënës nga komuna e Fushë Kosovës, me aftësi të kufizuara, nuk kanë mundur që të regjistrohen në një qendër (shkollë speciale), për shkak se Komuna e Fushë Kosovës nuk ka arritur ta krijojë komisionin për të vërtetuar shkallën e aftësisë së kufizuar. Qasja e tillë e komunës, i ka pamundësuar atyre që të vijnë me rregull shkollimin. Rasti është adresuar në komunën e Fushë Kosovës dhe është në monitorim nga ana e Platformës. Platforma akoma nuk ka pranuar përgjigje konkrete lidhur me zgjidhjen e rastit, pasi që komuna është kompetente për formimin e komisionit respektiv.

14. Dy raste në procedurë të trajtimit nga platforma-dallime etnike të nxënësve dhe mos veprim i institucioneve:

Lloji: Diskriminim kolektiv dhe individual

Përshkrimi: Platforma së fundi, mes datave 11-15 Nëntor 2023, ka pranuar edhe dy raste të reja, të cilat janë në analizim e sipër dhe do të adresohen tek institucionet kompetente. Në njërin rast kemi të bëjmë me mos veprim të institucioneve ligj zbatuese dhe në rastin tjetër me dallim që i është bërë fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në krahasim me nxënësit serb të një shkolle në Obiliq. Rastet janë duke u analizuar dhe do të adresohen nga ana e grupit teknik përmes platformës.

5.1.2. Rastet e tjera të raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të cilat nuk kanë rezultuar me diskriminim⁶⁸

Gjithsej janë 21 raste të cilat platforma i ka vlerësuar se nuk kanë pasur fushëveprim të diskriminimit, bazuar në legjislacionin e aplikueshëm (LMD) si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Këto raste janë regjistruar në platformë dhe figurojnë në databazën e saj dhe po ashtu si të tilla janë trajtuar nga ekipi profesional i platformës, me qëllim të adresimit profesional të tyre.

Arsyet e mosvlerësimit të këtyre rasteve si raste jo diskriminuese janë si vijon:

1. Raste vetëm të regjistruara, ku personi (subjekti) i diskriminuar edhe kontakti i tij/saj ka qenë i panjohur dhe se në përshkrimin të raportimit e tyre nuk kanë paraqitur asnjë dëshmi të diskriminimit. Zakonisht përshkrimi në platformë për këto raste ka qenë shumë i shkurtë dhe si i tillë i pamjaftueshëm që rasti të iniciohet tutje në institucionet kompetente.

2. Rastet të cilat janë trajtuar, por palët nuk kanë bashkëpunuar me platformën, duke mos sjellë prova konkrete për atë që kanë raportuar. Në këto raste, stafi profesional i platformës në vazhdimësi i ka kontaktuar palët për të sjellë dëshmi shtesë. Të tilla janë të raportuara 3 raste.

Si rezultat, të gjitha rastet kësaj kategorie janë trajtuar profesionalisht nga platforma por nuk ishte e mundur të procedohen tek institucionet kompetente, sipas LMD.

Të gjitha rastet e paraqitura në këtë pjesë të raportit dhe të përshkruara, janë sipas renditjes së paraqitur në platformë, bazuar në një kronologji të kohës së raportimit dhe regjistrimit në databazën e platformës.

1. Rasti i gjuhës diskriminuese të përdorur në një realityshow:

Lloji: Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi mediatik

Përshkrimi: Një raport anonim është bërë në Platformë në lidhje me gjuhën diskriminuese të përdorur ndaj komuniteteve në një realityshow. Gjuha në mënyrë specifike u referohej atyre si "Magjup". Platforma mori masa duke trajtuar rastin dhe duke nënvizuar pasojat e shaktuara nga video diskriminuese. Produksioni është përgjigjur duke hequr videon dhe çështja tashmë konsiderohet e mbyllur.

2. Rasti i diskriminimit i raportuar ndaj Komunës së Klinës:

Lloji: Diskriminim i pretenduar nga një institucion publik

Përshkrimi: Një raport anonim për diskriminim është bërë ndaj Komunës së Klinës dhe është raportuar në Platformë. Platforma e ka adresuar rastin dhe ka marrë përgjigje nga Komuna e Klinës se ky rast nuk ka të bëjë me diskriminim.

3. Rasti i kallëzimit anonim të diskriminimit ndaj kompanisë së transportit të udhëtarëve:

Lloji: Diskriminim i pretenduar nga një kompani private

Përshkrimi: Një kallëzim anonim i diskriminimit është bërë ndaj një kompanie të transportit të udhëtarëve dhe është raportuar në Platformë. Ndonëse nuk dihet se cila është pala e diskriminuar, Platforma e ka trajtuar këtë rast. Ministria kompetente për infrastrukturën (MMPHI) i është përgjigjur Platformës lidhur me rastin. Detajet e përgjigjes dhe rezultati nuk jepen, por përmendet se rasti konsiderohet i mbyllur.

⁶⁸ Rastet nga 1-13 i kësaj kategorie janë trajtuar edhe në Raportin, Mbrojtja nga Diskriminimi, Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e përpjekjeve një vjeçare të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet, Rom, Ashkali dhe Egjiptian (2022-2023), versioni anglisht, f.13-15.

4. Rasti anonim i raportuar në Pejë:

Lloji: Diskriminim i pakualifikuar

Përshkrimi: Në Pejë është bërë një raport anonim, i cili ka dhënë vetëm një fjalë pa ndonjë informacion shtesë. Për shkak të mungesës së detajeve, dhe kontakteve platforma nuk ka mundur të trajtojë rastin.

5. Rast anonim i raportuar në Fushë Kosovë ku përmendet "racizmi":

Lloji: Racizëm i supozuar

Përshkrimi: Një raport anonim është bërë në Fushë Kosovë, ku është përmendur fjala "racizëm" pa asnjë informacion të mëtejshëm. Platforma nuk ishte në gjendje të trajtonte çështjen për shkak të mungesës së detajeve.

6. Rast anonim i diskriminimit i raportuar në Pejë:

Lloji: Diskriminim i pakualifikuar

Përshkrimi: Një rast tjetër i diskriminimit është raportuar në mënyrë anonime në Pejë, pa asnjë informacion përveç një fjale. Platforma nuk mundi ta trajtonte rastin për mungesë detajesh.

7. Rast anonim i diskriminimit i raportuar në një biznes privat në Fushë Kosovë:

Lloji: Diskriminim i panjohur në një biznes privat

Përshkrimi: Një rast i diskriminimit është raportuar në një biznes privat në Fushë Kosovë, me vetëm një fjali të dhënë dhe asnjë informacion shtesë. Platforma nuk ishte në gjendje të trajtonte çështjen për shkak të mungesës së detajeve.

8. Rasti anonim i diskriminimit drejtuar kryeministrit të Kosovës:

Lloji: Diskriminim i panjohur drejtuar Kryeministrit

Përshkrimi: Një person anonim i ka shkruar një letër të hapur Kryeministrit të Kosovës lidhur me diskriminimin. Megjithatë, rasti nuk ka mundur të trajtohet për shkak të mungesës së informacionit, anonimitetit dhe mënyrës së raportimit.

9. Rasti anonim i diskriminimit ndaj Qeverisë së Kosovës:

Lloji: Diskriminim i supozuar nga qeveria

Përshkrimi: Një raport anonim pretendonte se Qeveria e Kosovës mohon ekzistencën e Egjiptianëve të Kosovës. Rastit i mungojnë informacionet thelbësore dhe personi mbetet anonim.

10. Rast anonim i diskriminimit i raportuar në lokalitetin "Retro" në Gjakovë:

Lloji: Diskriminim i pakualifikuar në një biznes

Përshkrimi: Një person anonim ka raportuar një rast të diskriminimit në biznesin afarist "Retro" në Gjakovë. Asnjë informacion nuk u dha, dhe pala e prekur nuk la asnjë detaj kontakti ose nuk dha shpjegime të mëtejshme për diskriminimin.

11. Rast anonim i diskriminimit në një institucion shëndetësor në Fushë Kosovë:

Lloji: Diskriminim i pretenduar në një institucion shëndetësor

Përshkrimi: Një person pretendon se ka përjetuar diskriminim në një institucion shëndetësor në Fushë Kosovë. Megjithatë, personi që ka raportuar rastin mbetet anonim dhe Platforma nuk ka mundur ta trajtojë rastin për shkak të mungesës së informacionit dhe provave bazë.

12. Rasti i diskriminimit i raportuar nga një pjesëtar i komunitetit Rom (Rasti 1):

Lloji: Pretendim i pabazuar për diskriminim

Përshkrimi: Një pjesëtar i komunitetit Rom, raportoi një rast të diskriminimit në platformë, duke ofruar disa detaje se si ndodhi incidenti. Ekipi i Platformës e trajtoi rastin dhe u takua meartinë për të diskutuar çështjen. Megjithatë, pavarësisht diskutimeve, pala nuk arriti të sigurojë prova konkrete të diskriminimit apo të identifikojë subjektet përgjegjëse për të. Rasti mbetet i pazgjidhur për shkak të mungesës së provave mbështetëse.

13. Rasti i diskriminimit i raportuar nga i njëjti pjesëtar i komunitetit Rom (Rasti 2):

Lloji: Pretendim i pabazuar për diskriminim

Përshkrimi: I njëjti individ nga komuniteti Rom raportoi një rast të veçantë të diskriminimit në Platformë. Ky rast dallon nga ai i mëparshmi për nga natyra e tij. Përsëri, ekipi i Platformës u angazhua meartinë dhe diskutoi rastin, por partia nuk arriti të sigurojë prova konkrete apo të identifikojë subjektet e përfshira në diskriminimin e pretenduar. Rasti mbetet i pazgjidhur për shkak të mungesës së provave mbështetëse.

14. Rast anonim për diskriminimin nga personat fizik:

Lloji: Diskriminimi i pretenduar nga personat fizik

Përshkrimi: Një person që ka dashur të mbetet anonim, pretendon që është dhe e cila punon në KFOR, pretendon që është duke u diskriminuar nga disa kolege të saj të kombësisë shqiptarë. Platforma nuk ka arritur të ndërmarr asnjë veprim në mungesë të informacioneve tjera dhe kontakteve të raportuesit.

15. Rast i gjuhës së urrejtjes në Obiliq:

Lloji: Diskriminimi i pretenduar/gjuhë e urrejtjes

Përshkrimi: Një person anonim raporton që është ushtruar gjuhë e urrejtjes në Obiliq. Megjithatë në Platformë nuk janë raportuar, as të dhëna dhe as detaje tjera që do të ndihmonin në adresimin e rasteve nga platforma.

16. Rast që adreson çështjet e Platformës:

Lloji: Nuk ka diskriminim

Përshkrimi: Një person i komunitetit Rom raporton dhe kërkon që platforma për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të përkthehet në gjuhën Rome. Ekipi i platformës i është përgjigjur personit lidhur me çështjen e ngritur.

17. Rast i mohimit të të drejtës së pronës përmes uzurpimit:

Lloji: Diskriminim i shoqëruar me vepër penale

Përshkrimi: Një person anonim pjesëtar i komunitetit Rom, ka raportuar që në Prizren, është duke u mohuar ushtrimi i të drejtës së pronës, përmes uzurpimit të lokalit afarist nga një person tjetër, mbi baza etnike. Platforma nuk ka asnjë të dhënë tjetër lidhur me raportimin dhe nuk ka mundur të kontaktojë me palën raportuese.

18. Rast i mohimit të regjistrimit në një "klub fitnesi":

Lloji: Diskriminim nga sektori privat

Përshkrimi: Një person anonim, raporton që po i mohohet regjistrimin në një klub fitnesi, në komunën e Obiliqit, vetëm pse ai i përket komunitetit Rom. Platforma nuk ka pasur asnjë të dhënë dhe nuk ka mundur ta kontaktojë ankuesin/en anonim si dhe po ashtu nuk është paraqitur asnjë dëshmi në databazë që vërteton çështjen e raportuar.

19. Dy raste tjera të raportuara anonim dhe pa objekt

Lloji: Jo ekzistent

Përshkrimi: Dy raste tjera të raportuara si anonime, kanë shkruar vetëm nga një fjalë në Platformë, respektivisht fjalën “diskriminim” dhe fjalën “Bullying”. Nuk ka pasur asnjë të dhënë tjetër dhe se platforma nuk ka mundur t'i kontaktojë raportuesit.

20. Diskriminimi në sferën e artit muzikor

Lloji: Diskriminim individual

Përshkrimi: Një person anonim raporton që në një këngë, ku marrin pjesë dy këngëtar shqiptar dhe një i komunitetit Rom, e cila është publikuar edhe në kanal youtube, nuk përmendet emri i pjesëtarit të komunitetit Rom. Platforma nuk ka mundur që të vazhdojë me procedurat e mëtutjeshme për shkak të mungesës së informacioneve dhe identitetit të raportuesit.

21. Gjuha e urrejtjes e shkaktuar nga një mjeke

Lloji: Diskriminim i supozuar/gjuhë e urrejtjes

Përshkrimi: Një ankues/e anonim pretendon që një mjeke nga komuna e Gjilani, në rrjetin social facebook ka përdorur shprehje raciste në adresë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, duke përdorur termin “zezak”. Pala raportuese nuk ka ofruar prova lidhur me këtë rast si dhe me identitetin e tij/saj.

22. Diskriminimi nga biznesi privat në Gjakovë

Lloji: Diskriminim i supozuar

Përshkrimi: Një raportues/e anonim thekson që për shkak se i përket komunitetit egjiptian, i njëjti është larguar nga një lokal, vetëm pse i përket komunitetit respektiv. Megjithatë platforma nuk ka asnjë informacion se ku dhe si ka ndodhur rasti si dhe platforma nuk është e njohur me identitetin e raportuesit/es.



6. Ndikimi i parandalimit dhe luftimit të diskriminimit nëpërmjet Platformës Kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Përgjatë 17 muajve të punës së saj, që nga themelimi i platformës, krahas rasteve tjera të raportuara direkt në të, grupi teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit ka trajtuar edhe 7 raste të cilat ishin paraqitur si vijon: 5 pranë Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit (2019) dhe 2 pranë grupit teknik (2021), parase të bëhej lansimi i Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Këto raste janë regjistruar në databazën e platformës dhe janë duke u monitoruar nga platforma në vazhdimësi, deri në përfundimin e tyre. Po ashtu këto raste janë trajtuar në tërësinë e statistikave të nxjerra në këtë raport, pasi që kanë qenë të regjistruara manualisht në databazën e platformës, pas lansimit të saj në 2022.

Ekipi profesional i platformës,⁶⁹ pas raportimit të secilit rast ka ndjekur një metodologji të punës dhe veprimeve vijuese si: analizimi i fakteve; komunikime me palën/palët raportuese; mbledhja dhe shqyrtimi i provave respektive të dorëzuara nga pala/palët raportuese; takimet me palët; përgatitja e raportit analitik për rastin; përgatitja e shkresave për adresimin e rastit në institucionet përgjegjëse sipas LMD (Avokati i Popullit, institucionet lokale/administrative; institucionet qendrore; Prokurorin e Shtetit; Policinë e Kosovës dhe Gjykatat kompetente); monitorimin e rastit sipas nevojës, në të gjitha fazat e mbarëvajtjes.

Përgjatë punës së ekipit të platformës, rastet anonime janë trajtuar me raporte për secilin rast, por pa pasur mundësi të adresohen, për shkak të mungesës së subjektit që është diskriminuar si dhe informacioneve (dëshmive) lidhur me diskriminimin eventuale. Në anën tjetër, në disa raste raportuesit nuk janë përgjigjur që të sjellin fakte dhe prova që dëshmojnë qështjet e ngritura në raportim dhe si rezultat rasti nuk ka pasur mundësi të adresohet, si pasojë e vullnetit të palëve, pavarësisht takimeve të realizuara.⁷⁰



Platforma përgjatë 17 muajve të punës së saj nga momenti i lansimit ka arritur të shërbejë si një dritare e rëndësishme për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me qëllim të mbrojtjes nga diskriminimi duke shënuar tërësisht 15,296 vizitorë.

Platforma përgjatë 17 muajve të punës së saj nga momenti i lansimit ka arritur të shërbejë si një dritare e rëndësishme për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me qëllim të mbrojtjes nga diskriminimi. Për një (1) vit të punës së saj, platforma ka arritur të ketë 9976 vizitorë,⁷¹ indikator ky që tregon përhapjen e saj (platformës) brenda komuniteteve respektive. Në vitin 2023, në pjesën e dytë të vitit 2023, numri i vizitorëve është rritur në platformë është rritur 15,296. Pra vetëm për 5 muaj, respektivisht në periudhën Korrik-Nëntor, platforma ka pasur rritje të për 5320 vizitorë.

⁶⁹ Ekipi profesional i platformës përbëhet nga: zyrtarët e Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit; ekspert juridik; administratoren e platformës; personat përgjegjës të caktuar nga partnerët mbështetës në kuadër të projektit siç është TDH.

⁷⁰ Rastet e tilla janë ato të parashtruara nga pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian K.K. dhe L.Q.

⁷¹ Raportin, Mbrojtja nga Diskriminimi, Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e përpjekjeve një vjeçare të Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet, Rom, Ashkali dhe Egjiptian (2022-2023), versioni anglisht, f.6.

Ndërkohë që për një vit të punës së saj (Qershor 2021-Qershor 2022) në platformë janë raportuar 23 raste në tërësi.⁷² Ndërkaq, vetëm nga muaj Qershor 2023 deri në muajin Nëntor 2023, në distancë kohore pesë (5) muajve, në platformë janë raportuar 16 raste të reja. Ky fakt nënkupton që në platformë në periudhën korrik-nëntor 2023, janë raportuar mbi 70% të rasteve që ishin raportuar gjatë gjithë vitit, respektivisht Qershor 2021-Qershor 2022. Ky argument tregon për një rritje të dukshme të numrit të raportuesve në platformë, një rritje të vetëdijësimit për rëndësinë e raportimit të rasteve si dhe kjo përbën një vlerësim të punës për platformën.

Përderisa në periudhën një vjeçare të punës, në kuadër të platformës, nga 23 raste të raportuara 2 prej rasteve ishin të kompletuara, deri në nëntor 2023,⁷³ krahas rasteve të reja të paraqitura, 7 raste janë të kompletuara në tërësi. Në anën tjetër, përderisa në një vjetorin e punës së platformës, nga 23 raste të raportuara, 10 prej tyre ishin në proces, në muajin Nëntor 2023,⁷⁴ nga 39 raste të raportuara, vetëm 9 prej rasteve janë duke pritur në procedurë të trajtimit pranë institucioneve kompetente sipas LMD-së. Kjo tregon një rritje të efikasitetit dhe të bashkëpunimit me institucione në adresimin e rasteve.

Megjithatë, krahasuar me punën një vjeçare të platformës, rritja e numrit të rasteve të raportuara në 39, ka rritur edhe numrin e rasteve anonime të raportuara, në gjithsej 17, nga 8 sa ishin në periudhën një vjeçare. Kjo tregon një trend të njëjtë të raportuesve dhe qartazi një hezitim të tyre për të raportuar rastet haptazi. Po ashtu kjo përbën një çështje në vete e cila kërkon një adresim më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, përveç platformës dhe grupit teknik.

Ajo çfarë e veçon periudhën 5 mujore të raportimit të rasteve (Korrik-Nëntor 2023) lidhet me faktin se nga 16 raste të paraqitura përgjatë kësaj periudhe, 5 raste⁷⁵ janë paraqitur për diskriminim në fushën e arsimit, që lidhen me situata të caktuara nëpër shkolla dhe që kanë rezultuar edhe me ndërprerje të mësimit të nxënësve.



⁷² Po aty, f.6.

⁷³ Po aty, f.9.

⁷⁴ Po aty f.9.

⁷⁵ Tri nga këto raste kanë të bëjnë me Komunën e Fushë Kosovës, një me komunën e Obiliqit dhe një rast tjetër me komunën e Prizrenit. Që të tria përbëjnë diskriminim ndaj fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

6.1 Vlerësimi i platformës nga pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe problemet e shprehura përtej saj

Me qëllim të hartimit të këtij raporti dhe vlerësimit të punës së platformës, është organizuar një fokus grup, me pjesëtar të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Qendrën Ditore e Fëmijëve në Prishtinë, e cila udhëhiqet nga TdhK dhe Komuna e Prishtinës. Grupmosha e pjesëmarrësve në takim, ka qenë nga 25 vite e tutje dhe të gjitha pjesëmarrëset kanë qenë femra të martuara dhe me më së paku 3 fëmijë.

Në kuadër të bashkëbisedimit me pjesëmarrëset në takim, të gjitha pjesëmarrëset kanë deklaruar që kanë telefona të mençur dhe se kanë dëgjuar gjerësisht për platformën, mirëpo nuk janë kyçur asnjëherë në platformë për të raportuar raste përmes telefonit, pasi që rastet i kanë raportuar përmes Qendrës Ditore të Fëmijëve në Prishtinë.

Në pyetjen e diskutuar me pjesëmarrësit se a kanë qenë ata/ato ndonjëherë viktimë e diskriminimit mbi baza etnike dhe se a e kanë adresuar rastin, shumica prej tyre janë përgjigjur që nuk kanë qenë viktimë e diskriminimit personalisht. Vetëm dy prej pjesëmarrësve kanë deklaruar që janë ndjerë të diskriminuar, në një situatë ku e përfshirë ka qenë kompania e transportit publik dhe një punonjës i saj, kurse në një rast tjetër një pjesëmarrëse në takim nuk kishte marrë kujdesin e duhur nga një mjek në Prishtinë për fëmijën e saj. Megjithatë këto dy raste nuk ishin raportuar për shkak të mungesës së besimit në institucione.⁷⁶

Në pyetjen e diskutuar përgjatë takimit, lidhur me vështirësitë për raportimin e rasteve në platformë, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit nuk kanë mundur të përgjigjen, për shkak se nuk kanë pasur mundësinë që të raportojnë ndonjë rast në platformë personalisht, ndërkaq pohojnë që se kanë dëgjuar që persona të tjerë rastin në platformë.⁷⁷

Në pyetjen e diskutuar në takim se a mendoni se rrethi juaj në komunitetin tuaj ka dëgjuar për platformën si adresë për të raportuar rastet e diskriminimit, të gjithë pjesëmarrësit kanë pohuar se rrethi i tyre kanë dëgjuar për platformën dhe kanë përmendur një rast të koleges së tyre, e cila ka raportuar rastin në platformë, përmes Qendrës Ditore në Prishtinë.⁷⁸

Në pyetjen tjetër të trajtuar në takim se a besoni se rasti do të zgjidhet nëse e adresoni në platformë, të gjithë pjesëmarrësit kanë pohuar që platforma është një mundësi e mirë për të luftuar diskriminimin, përveç një pjesëmarrëse e cila është shprehur skeptike për shkak të humbjes së besimit në institucionet kompetente për luftimin e diskriminimit. Të gjitha pjesëmarrëset pajtohen po ashtu që platforma do të ndihmojë për zgjidhjen e disa problemeve të diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, përveç një personi që shpreh dyshimet në besimin, jo ndaj platformës por institucioneve kompetente.⁷⁹

Në lidhje me punën e platformës po ashtu, të gjithë pjesëmarrësit në takim janë pajtuar që do të bisedojnë me fqinjët e tyre që ata/ato të raportojnë sa më shumë raste të diskriminimit në platformë.⁸⁰

Megjithatë, përveç çështjeve të diskutuara për platformën, pjesëmarrëset në takim theksuan një varg problemesh që kanë të bëjnë me jetën e pjesëtarëve të komuniteteve, Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Të gjitha pjesëmarrëset theksuan problemet sociale dhe pamundësinë që me ndihmat sociale që i marrin të mbulojnë shpenzimet për muaj, ndërkohë që pjesëmarrëset në takim ishin nëna të 3-6 fëmijëve. Ndërkohë në të gjitha rastet, familjarët dhe bashkëshortët e pjesëmarrësve në takim punojnë vetëm në sektorin privat pa kontratë pune dhe pas asnjë garancion tjetër sipas ligjit.

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Takimi i zhvilluar në Qendrën Ditore në Prishtinë, datë 21.11.2023, ora 11:00.

7. Masat e ndërmarra për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Masat e ndërmarra për zbatimin e LMD, veçanërisht për komunitetet Rom, Ashkali edhe Egjiptian janë të lidhura me aspektin e përgjithshëm të mbrojtjes nga diskriminimi dhe zbatimin e LMD. Njëra ndër masat kryesore të ndërmarra nga Qeveria në lidhje me zbatimin e LMD lidhur me çështjen e zbatimit të LMD është vetë puna e platformës, e cila është duke paraqitur një mekanizëm shtesë lehtësues që ju ndihmon komuniteteve Rom, Ashkali edhe Egjiptian për të adresuar rastet e diskriminimit.

Në raport me masat e ndërmarra për zbatimin e LMD, Qeveria ka miratuar raportin Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili përcakton qartë parametrat e zbatimit dhe mos zbatimit të LMD.⁸¹ Të gjitha parametrat e pengesave në zbatimin e LMD të theksuara në raportin e vlerësimit ex post të LMD, ndërlidhen me rastet e raportuara në platformë.

Raporti për vlerësimin ex post të LMD ka theksuar se mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi nuk janë funksionalizuar sipas Rregullores (QRK) - Nr. 03/2017 për Mekanizmat

Institucional për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna duke mos u unifikuar emërimi, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive apo zyrtarit përkatës për Mbrojtje nga Diskriminimi.⁸² Edhe në ankesat dhe kërkesat e adresuara nga platforma në komunat përkatëse në lidhje me rastet e raportuara, në përgjigjet e dhëna asnjëherë nuk janë aktivizuar zyrtarët përkatës për Mbrojtje nga Diskriminimi. Kjo përbën një indikator të qartë se këta zyrtar janë shumë pak funksional në komunat respektive. Në këtë rast vlen të përmendet rasti i Fushë Kosovës, ku përgjatë muajt Korrik-Nëntor, janë raportuar disa raste të diskriminimit në platformë. Madje në disa raste edhe ka pasur vonesë të përgjigjes nga komuna e Fushë Kosovës dhe kjo përgjigje është dhënë pa përfshirjen e zyrtarëve për diskriminim.⁸³

“Ka shumë raste kur individët, grupet apo komunitetet e caktuara mund të jenë të diskriminuara, por ato nuk i iniciojnë këto raste, në përputhje me nenin 12 dhe 13 të LMD-së, për shkak të mungesës së njohurive të mjaftueshme për këtë ligj, frikës nga ndëshkimi, stigmatizimit të tyre, apo edhe mungesës së besimit në mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi dhe organet e drejtësisë”,⁸⁴ thekson raporti për vlerësimin ex post të LMD.

Edhe në rastin e platformës dhe rasteve të raportuara në të është vërejtur që pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali edhe Egjiptian, i kanë raportuar rastet kryesisht anonime, kryesisht nën frikën nga ndëshkimi ose mungesës së njohurive të mjaftueshme. Nga të gjitha 39 rastet e paraqitura, 17 prej tyre janë raportuar si anonime, pa dëshmi konkrete që lidhen me diskriminimin eventual.

Një problem sipas raportit ex post për zbatimin e LMD është edhe mungesa e praktikës së unifikuar gjyqësore në lidhje me zbatimin e 13, 14, 16 dhe 17 të LMD, nëse këto që kanë të bëjnë me zbatimin e LMD nga gjykatat dhe për këtë çështje Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të nxjerrë politika të caktuara që do të mundësojnë unifikimin e praktikës gjyqësore.⁸⁵

⁸¹ Raporti i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është miratuar në Mbledhjen e 159-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendim Nr. 05/159, të datës 13.09.2023.

⁸² Po aty, f.10.

⁸³ Rasti E.K i raportuar në platformë nga E.G.

⁸⁴ Raporti i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është miratuar në Mbledhjen e 159-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendim Nr. 05/159, të datës 13.09.2023, f.11.

⁸⁵ Raporti i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është miratuar në Mbledhjen e 159-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendim Nr. 05/159, të datës 13.09.2023, f.12.

Një çështje tjetër që ka të bëjë me zbatimin e LMD është edhe prioritizimi i rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin. Një gjë e tillë i ka bërë jo efikas të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e LMD, përkundër obligimit ligjor që rastet duhet të trajtohen me urgjencë, sipas neni 16 (9) të LMD.⁸⁶ Mos prioritizimi i rasteve ka ndikuar edhe në punën e platformës, për shkak të ngadalësisë në trajtim nga institucionet kompetente të rasteve të raportuara.

Në rastet e raportuara në platformë, Avokati i Popullit, të njëjtat i ka pranuar që nga data 20 prill 2023 dhe që nga momenti i pranimit, deri me datë 20 nëntor 2023, kanë kaluar 7 muaj dhe platforma nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga IAP në lidhje me rastet.⁸⁷ Sipas rregullores së punës të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), hetimi i një rasti më së shumti mund të zgjasë 6 muaj dhe pas kalimit të këtij afati duhet të paraqitet arsyetim i veçantë për çdo muaj në lidhje me rastin.⁸⁸ Po ashtu edhe në rastet e tjera të raportuara në platformë, nuk është vërejtur ndonjë element të trajtimit me urgjencë, sipas obligimit që përcakton LMD. Madje në njërin nga rastet e trajtuara, Prokurori i shtetit nuk e ka ftuar raportuesin e rastit as në intervistë si palë e dëmtuar.⁸⁹

Një problem në vete lidhur me zbatimin e LMD po ashtu paraqitet edhe çështja e mungesës së resurseve financiare dhe atyre njerëzore.⁹⁰ Nuk mund të përjashtohet edhe fakti që ngadalësia e trajtimit të rasteve të platformës të lidhet edhe me çështjen e mungesës së këtyre resurseve. Një çështje tjetër e lidhur me zbatimin e LMD dhe që ndërlidhet me platformën ka të bëjë me rekomandimin e raportit të vlerësimit ex post të LMD, sipas të cilit gjykata dhe prokuroritë duhet të regjistrojnë rastet e diskriminimit në databazë, sipas një regjistrimi të veçantë.⁹¹

Platforma duke qenë njëra ndër mekanizmat kryesore që ndikon në lehtësimin e zbatimit të LMD, ka ndikuar në zbatimin e këtij ligji përmes adresimit të rasteve në të gjitha mekanizmat që njeh LMD për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit. Rastet e raportuara në platformë janë adresuar në të gjitha mekanizmat që i njeh LMD, siç janë: Avokati i Popullit; Gjykata Kompetente; Prokuroria kompetente; Policia; niveli lokal; Inspektoratin e Arsimit etj.⁹² Gjithashtu në kuptim të zbatimit të LMD, platforma ka shërbyer dhe shërben si një mekanizëm shtesë që ndihmon në luftimin e diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali edhe Egjiptian edhe për shkakun se shumica e rasteve të paraqitura para lansimit të platformës nuk janë trajtuar ose kanë pasur pak rezultate.

⁸⁶ Po aty, f.13.

⁸⁷ Rastet e platformës të dorëzuara në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe të regjistruara me numër 331/2023 dhe 332/2023.

⁸⁸ Rregullorja e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit 02/2016, neni 55.

⁸⁹ Bëhet fjalë për ankuesin D.Q., rasti i të cilit tani është duke u trajtuar po ashtu nga Avokati i Popullit.

⁹⁰ Raport i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është miratuar në Mbledhjen e 159-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendim Nr. 05/159, të datës 13.09.2023, f.14.

⁹¹ Po aty, f.20.

⁹² Disa nga këto raste janë adresuar dhe përfunduar, disa të tjera janë në procedurë të adresimit, sipas statistikave të paraqitura në shtojcë.

8. Bashkëpunimi ndër-institucional në trajtimin (menaxhimin) e rasteve të diskriminimit që janë raportuar në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Rastet e raportuara në platformë që nga fillimi i punës së saj, janë trajtuar sipas një metodologjie të punës që ndjek logjikën e institucioneve kompetente sipas LMD dhe institucioneve që përcaktohen me ligjet e veçanta. Të gjitha rastet tek institucionet janë punuar nga ekipi profesional i platformës dhe janë adresuar nga grupit teknik, që kryesohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit.

Me rastin e raportimit, platforma sipas rregullave të vendosura nga grupi teknik ka analizuar rastin dhe për secilin rast ka përgatitur një raport analitik, duke dhënë rekomandime, përfshirë edhe institucionet në të cilat duhet të adresohet rasti. Ekipi profesional i platformës dhe grupi teknik, fillimisht të gjitha rastet i ka adresuar tek institucionet në të cilat ka ndodhur diskriminimi, me qëllim të parandalimit të tyre si dhe tek institucionet tjera kompetente për luftimin e diskriminimit sipas LMD.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër institucional, në disa raste ka pasur një efikasitet të kënaqshëm në trajtimin e rasteve nga disa prej institucioneve. Një shembull i tillë mund të përmendet Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), e cila në mënyrë profesionale ka trajtuar rastet e adresuara nga platforma.⁹³

Po ashtu, në rastin e diskriminimit të fëmijëve në një shkollë në komunën e Prizrenit, platforma ka pranuar përgjigje të shpejtë, brenda 24 orëve nga Drejtoria Komunale e Arsimit, për trajtimin rastit dhe parandalimit të diskriminimit.⁹⁴

Gjithashtu edhe në rastet e diskriminimit që kanë ndodhur në Komunën e Fushë Kosovës, ndonëse ekipi i platformës ka ndërmarrë veprime të menjëhershme, megjithatë është vërejtur një vonesë në kthimin e përgjigjeve nga Komuna e Fushë Kosovës si dhe përgjigjet e pranura nuk kanë qenë adekuate dhe nuk kanë sqaruar çështjet e ngritura nga ekipi i platformës.⁹⁵

Përsa i takon rasteve të raportuara tek Avokati i Popullit, edhe pse kërkesat e pranura për trajtim, që nga muaj prill 2023, ekipi i platformës dhe grupi teknik nuk ka marrë përgjigje në lidhje me këto raste edhe pse ka kaluar afati prej 6 muajve për hetimin e rastit, siç përcaktohet në rregulloren e punës së Avokatit të Popullit.⁹⁶

Ndërkaq është evidente procedura e trajtimit të rasteve nga Gjykata, ndonëse është obligim ligjor sipas LMD, neni 16.9 të trajtohen me prioritet, nuk është bërë një gjë e tillë.⁹⁷

Inspektorati i Arsimit, në trajtimin të diskriminimit që ka ndodhur në Komunën e Fushë Kosovës, ka kthyer përgjigje brenda ditës, duke njoftuar platformën për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me rastin si dhe ka dalë me raport dhe rekomandime në lidhje me rastin e raportuar.⁹⁸ Në bazë të statusit të rasteve, në kuptimin e trajtimit të tyre, përveç rasteve të mbyllura dhe të përfunduara nga platforma ose të përfunduara me një vendim të Institucioneve, ka edhe raste janë raportuara anonime ose janë në procedurë të trajtimit nga institucionet.

Tabela e mëposhtme pasqyron gjendjen e bashkëpunimit ndër-institucional në menaxhimin e rasteve të raportuara në platformë për 17 muaj të punës së saj, respektivisht deri me 15 nëntor 2023.

⁹³ Rastet, M.K, M.B, B.B dhe D.I.

⁹⁴ Rasti i raportuar nga N.G.J.

⁹⁵ Rasti i raportuar nga E.G dhe rasti ku e diskriminuar është E.K.

⁹⁶ Rastet e platformës të dorëzuara në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe të regjistruara me numër 331/2023 dhe 332/2023.

⁹⁷ Raporti Vlerësimi Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është miratuar në Mbledhjen e 159-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendim Nr. 05/159, të datës 13.09.2023, f.13.

⁹⁸ Rasti E.K, i raportuar nga E.G është duke u trajtuar me prioritet nga Inspektorati i Arsimit, sipas përgjigjeve të pranura nga sekretariati i grupit teknik/Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit.

Rastet e trajtuara sipas institucionit dhe statusit procedural të trajtimit të rastit në periudhën Qershor 2022-Nëntor 2023

Institucioni që është duke e trajtuar rastin	Numri	Procedura/statusi e rastit që është duke u trajtuar
Avokati i Popullit	1	I trajtuar me raport exofficio 18.11.2023 ⁹⁹
Avokati i Popullit	1	Nuk ka raport ose rekomandim
Avokati i Popullit dhe Inspektorati i Arsimit	1	Nuk ka një vendim nga inspektorati ose Avokati i Popullit.
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	Nuk ka akoma vendim të shkallës së parë.
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	Është vërtetuar diskriminimi indirekt me aktgjykim të gjykatës.
Inspektorati i Arsimit dhe Avokati i Popullit	1	Duke u trajtuar dhe nuk ka ende vendim përfundimtar.
Komuna e Fushë Kosovës	1	Në pritje të vendimit/përgjigjes.
Komuna Prizren/Drejtorja e Arsimit	1	Rasti i përfunduar/parandalim i diskriminimit.
Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia e regjistrimit civil	4	Të përfunduara/nuk ka diskriminim.
Policia e Kosovës/Prishtinë	2	Në procedurë të hetimit.
Prokurori i shtetit	1	Në trajtim të kallëzimit penal.
Universiteti i Gjakovës	1	I trajtuar nga Universiteti.
Në proces të trajtimit nga platforma.	2	Duke mbledhur dhe analizuar informacionit dhe faktet.
Raste të regjistruara në platformë	21	Rastet vetëm janë regjistruar dhe nuk kanë rezultuar si diskriminuese, për shkak të mungesës së informacionit të raportuar në platformë, sipas sqarimeve të dhëna në raport.

39 RASTE

⁹⁹ Rasti i ngjashëm është trajtuar edhe nga Platforma dhe i njëjti është paraqitur tek Avokati i Popullit

9. Rastet e trajtuara nga institucionet dhe pasqyrimi i tri (3) tregimeve të suksesit

Nga të gjitha rastet e trajtuara në kohët e fundit, po i veçojmë tri raste të cilat mund të konsiderohen një tregime të suksesit që kanë të bëjnë me vërtetimin, parandalimin dhe luftimin e diskriminimit. Rastet janë si vijon:

1. Rasti, A.Q në të cilin me Aktgjykim të shkallës së parë është vërtetuar diskriminimi indirekt nga MSH;
2. Rasti i diskriminimit në SHFMU “Mati Logoreci” në Prizren, që përbën një parandalim të diskriminimit;
3. Rasti në të cilën Inspektorati i Arsimit ka arritur të parandalojë diskriminimin që po i bëhej nxënës E.K në Fushë Kosovë.

9.1 Rasti A.Q dhe vërtetimi i diskriminimit me aktgjykim të gjykatës

A.Q, pjesëtar i komunitetit egjiptian, në një betejë juridike që nga viti 2006/2007, në vazhdimësi ishte diskriminuar nga MSH, e cila nuk i kishte vërtetuar specializimin e tij dhe i kishte pamundësuar ushtrimin e të drejtës së profesionit. A.Q, pas ankesave të vazhdueshme rastin e kishte diskutuar me ekipin e platformës dhe grupin teknik. Aktualisht rasti i A.Q ka përfunduar me aktgjykim të shkallës së parë, sipas të cilit është vërtetuar që MSH e ka diskriminuar në mënyrë indirekte të njëjtin.

A.Q, për qëllime të hartimit të këtij raporti, sipas dakordimit me ekipin e platformës, lidhur me suksesin e rastit të tij është shprehur si vijon: “Pas një përpjekje të gjatë shumë vjeçare të përballjes me luftimin e diskriminimit, e cila ka filluar që nga viti 2004, për shkak se sjelljeve arbitrare dhe jo ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, ku mua më është mohuar e drejta e licencimit si kirurg i përgjithshëm dhe vaskular dhe ky mohim më është bërë në vazhdimësi, situatë kjo që më ka pamundësuar edhe ushtrimin e punës dhe profesionit tim në Kosovës. Unë përmes ekipit të platformës kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe egjiptian kam arritur të adresoj rastin tim në mënyrë profesionale. Tani rasti im ka përfunduar me aktgjykim të shkallës së parë dhe me këtë aktgjykim është vërtetuar vetëm diskriminimi indirekt i Ministrisë së Shëndetësisë ndaj meje. Do të vazhdojë ta ndjek rastin tim dhe të kërkojë kompensimin e demit i shkaktuar si pasojë e këtij diskriminimi dhe dënimin e artereve të involvuar në rast dhe për këtë kam marrë zotimin për ndihmë nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe ekipi i platformës kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe egjiptian”.

9.2 Rasti i SHFMU “Mati Logoreci” dhe parandalimi i diskriminimit

Ky rast është shfaqur në publik dhe është raportuar në platformë nga N.GJ. Sipas rrethanave të këtij rasti, raportohej që në SHFMU “Mati Logoreci” në Komunën e Prizrenit është raportuar që janë krijuar klasë vetëm me fëmijët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Grupi teknik dhe ekipi i platformës ka kontaktuar Drejtorinë kompetente për arsim në komunën e Prizrenit dhe ka komunikuar me shkresë me këtë drejtori. Drejtoria e Arsimit në Komunën e Prizrenit ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve për grupin teknik, duke ndërmarrë masa të menjëhershme dhe reagime për sqarimin e situatës dhe parandalimin e diskriminimit eventual.¹⁰⁰

9.3 Rasti i SHFMU “Selman Riza” dhe masat e ndërmarra nga Inspektorati i Arsimit

E diskriminuara është nxënëse e shkollës SHFMU Selman Riza në Fushë Kosovës. Ajo ishte privuar nga e drejta për arsim, përmes veprimeve të drejtorit të shkollës respektive. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe ekipi i platformës në vazhdimësi kishin tentuar të komunikonin¹⁰¹ me drejtorinë kompetente për arsim në komunën e Fushë Kosovës por nuk kishin marrë përgjigje adekuate dhe gjithashtu përgjigjet kishin ardhur me shumë vonesë. Rasti ishte adresuar në Inspektoratin e Arsimit më datë 21.11.2023. Inspektorati i Arsimit e ka njoftuar grupin teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, lidhur me rezultatet e inspektimit, meqë rast ka rekomanduar që ndaj drejtorit të shkollës të shqiptohet procedurë disiplinore kurse i ka rekomanduar drejtorisë së arsimit në Fushë Kosovë që ta trajtoj brenda 5 ditësh rastin e nxënëses dhe të njoftojë prindin e saj.¹⁰²

¹⁰⁰ Përgjigja drejtuar Sekretariatit të grupit teknik, me 7 shtator 2023 nga Drejtoresha e Arsimit në Komunën e Prizrenit, znj. Luljeta Veselaj.

¹⁰¹ Kërkesa drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Fushë Kosovë nga grupi teknik, me datë 26.09.2023.

¹⁰² Procesverbali i Inspektoratit të Arsimit, nr.430/11, datë 21.11.2023.

10. Përfundimet dhe rekomandimet

Platforma Kombëtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ka trajtuar me sukses 39 raste të diskriminimit brenda 17 muajve të funksionimit. Këto raste përfshijnë forma të ndryshme të diskriminimit, individual dhe kolektiv, në përputhje me ligjin ekzistues për mbrojtjen nga diskriminimi. Platforma, e menaxhuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe e mbështetur nga konsorciumi i përbërë TdhK në partneritet me VoRAE dhe HEKS/EPER, përbëhet nga një ekip profesional i përkushtuar për trajtimin e këtyre rasteve. Çdo rast i raportuar është analizuar tërësisht dhe për çdo rast janë vendosur kontakte me institucionet përkatëse, të përfshira në diskriminim. Pas analizës ligjore, rastet zakonisht i janë përcjellë institucioneve përgjegjëse për veprime të mëtejshme.

Ka qenë e dukshme përparimi i vazhdueshëm që ka arritur platforma, në numrin e rasteve, përfshirë edhe trajtimin e tyre. Kjo mund të shihet edhe me faktin se që në qershor të vitit 2023 në platformë numri i rasteve të raportuara ka qenë 23, kurse për 5 muaj, deri në Nëntor 2023, ky numër është rritur në 39, që nënkupton për 16 raste më shumë.

Është thelbësore të theksohet se trajtimi i rasteve të diskriminimit përmes platformës dhe drejtimi i tyre tek institucionet përkatëse ndjek një procedurë hetimore që kërkon kohë. Kjo nuk duhet t'i dekurajojë pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nga raportimi i rasteve. Në vend të kësaj, platforma duhet parë si një mekanizëm shtesë që i mbështet këto komunitete në luftën e tyre kundër diskriminimit. Pavarësisht punës dhe angazhimit në platformë si dhe angazhimit të grupit teknik, numri i rasteve anonime që raportohen dhe për të cilat nuk dorëzohen prova, ka vazhduar pothuajse në trendin e njëjtë, meqë rast deri më 15 Nëntor 2023, janë dorëzuar 17 raste anonime.

Platforma përgjatë 5 muajve, nga raporti i një (1) vjetorit të punës platforma ka arritur një rritje të dukshme të raportimit të rasteve. Vetëm në periudhën 5 mujore në platformë janë raportuar 16 raste të reja. Kjo tregon rritjen e vetëdijes dhe kurajon e shtuar të komuniteteve Rom, Ashkali dhe egjiptian për të raportuar rastet.

Gjithashtu, nga raportimi i fundit i një (1) vjetorit të punës së platformës, nga 3 raste sa kanë qenë të përfunduara, për periudhën 5 mujore janë përfunduar edhe 4 raste shtesë, respektivisht në tërësi 7 raste si dhe 9 prej tyre janë në procedurë të trajtimit nga ana e institucioneve. Ky argument tregon edhe rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë në trajtimin e rasteve nga institucionet.

Prej të gjitha rasteve të raportuara është evidente që një rast i trajtuar nga platforma ka përfunduar me aktgjykim për vërtetimin e diskriminimit. Ky përbën një sukses të grupit teknik, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe platformës, për shkak se në praktikën gjyqësore të rralla janë rastet që përfundojnë me aktgjykim të gjykatës, i cili vërteton diskriminimin.

Në përgjithësi, përgjatë takimeve që i ka zhvilluar ekipi i platformës me institucionet që në të cilat janë adresuar rastet kanë pasur një bashkëpunim korrekt, edhe pse në disa raste me vonesa, nëntë (9) rastet që janë duke u adresuar nga platforma po trajtohen me një seriozitet nga ana e ekipit të institucioneve.¹⁰³

¹⁰³ Njëri nga këto raste është ai E.K, i cili është adresuar në Inspektoratin e Arsimit për një diskriminim në SHFMU Selman Riza në Fushë Kosovë. Sipas procesverbalit të dërguar nga grupit teknik nga ana e Inspektoratit të Arsimit me 21.11.2023, rezultoi që njëra nga rekomandimet është shqiptimi i masës disiplinore ndaj drejtorit të shkollës respektive.

Duke u bazuar në atë çfarë është theksuar më sipër, në vijim mund të japim këto rekomandime:

1. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit të vazhdojë me fushata që inkurajojnë raportimin e sa më shumë rasteve në platformë.
2. Organizatat e shoqërisë civile dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, bashkërisht duhet të vazhdojnë të ndërmarrin fushata të vazhdueshme për të vetëdijesuar komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për rëndësinë e raportimit të rasteve.
3. Grupi teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit duhet të vazhdojë të organizojnë sesione informuese me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për të parë situatën e tyre në terren dhe të organizojnë sesione informuese për të ju treguar qytetarëve Rom, Ashkali dhe Egjiptian rolin e tyre.
4. Grupi teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me komunat të komunikojnë me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për të marrë opinionet e tyre lidhur me përmirësimin dhe avancimin e platformës për raportimin e rasteve. Të përfshijnë qytetarët Rom, Ashkali dhe Egjiptian në procese të rëndësishme që lidhen me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të tyre ashtu që të ndikojnë në rritjen e besimit të këtyre institucioneve ndaj komuniteteve respektiv dhe uljen e numrit të rasteve anonime të raportuara në grupin teknik përmes platformës.
5. Institucioni i Avokatit të Popullit të prioritzojë trajtimin e ankesave që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Grupi teknik, duke përdorur argumentet ligjore të kërkoj nga institucionet kompetente (përveç Avokatit të Popullit) që rastet që pranohen bazuar në LMD, të prioritzohen dhe të trajtohen në afat më urgjent.
6. Grupi teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit përmes platformës të vazhdojnë të monitorojë rastet në proces deri në përfundimin e tyre dhe trajtimin nga ana e institucioneve kompetente.
7. Qasja e nxënësve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në arsim të mundësohet përmes mësimi plotësues dhe alternativ. Lidhur me këtë çështje të merren parasysh kërkesat e nxënësve dhe prindërve në komunat ku banojnë komunitetet respektive, në mënyrë që të zhvillohet mësimi alternativ.
8. Grupi teknik të vazhdojë të ofrojë më shumë udhëzime në gjuhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për përdorimin e platformës, sidomos aplikacionet përmes telefonit.
9. Grupi teknik duhet të vazhdojë të avokojë dhe të ndërmarrë veprime që edhe institucionet e tjera përveç Avokatit të Popullit t'i trajtojnë me urgjencë rastet e diskriminimit të raportuara në platformë.
10. Grupi teknik të shqyrtojë mundësinë që në kuadër të mbrojtjes nga diskriminimi për komunitetet jo shumicë, Rom, Ashkali dhe Egjiptian, përmes platformës dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF)t'i referoj të gjitha rastet që kanë nevojë për ndihmë juridike falas në ANJF.

11. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit të ndërmarrin veprime që përmes mekanizmave kushtetues të dhe të koordinojnë iniciimin e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit në fuqi për Mbrojtje nga Diskriminimi (LMD), me qëllim të caktimit të afateve strikte për prioritizimin e rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nga institucionet kompetente.

12. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe grupi teknik të vazhdojë të trajtojë dhe adresojë të gjitha rastet e raportuara në platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet, Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

13. Grupi teknik, t'i drejtohet herë pas here letra dhe kërkesa të gjitha institucioneve kompetente që zbatojnë LMD, me qëllim të ri informimit për punën e platformës dhe të kërkojë nga institucionet respektive që rastet që adresohen nga platforma, në këto kushte ligjore të trajtohen me prioritet, me qëllim që të ndalen pasojat e mundshme që mund të shkaktohen nga diskriminimi, ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

14. Rekomandohet për të gjithë raportuesit e rasteve të diskriminimit, që nëse të njëjtit nuk dëshirojnë ta raportojnë rastin me të dhënat e tyre (emri dhe mbiemri) të njëjtit të lënë vetëm një kontakt të emailit ose telefonit, në mënyrë që ekipi i platformës t'i kontaktojë ata/ato, për të adresuar rastin e tyre në mënyrë anonime dhe duke mbrojtur të dhënat e tyre, sipas kërkesës. Ky rekomandim të plotësohet përmes fushatave dhe sesioneve informuese, përmes grupit teknik, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, komunave dhe institucioneve tjera relevante, sipas LMD.


15. Grupi Teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit të mbështetur nga donatorët, të mbajnë takime me fokus grupe në mënyrë që të lehtësojnë qasjen e paraqitjes së rasteve në platformë si dhe brenda mundësive financiare, të bëhen disa avancime teknike në përdorimin e platformës, në mënyrë që ajo të jetë më lehtë e përdorshme për palët në kuptimin e raportimit dhe të komunikimit me raportuesit, në mënyrë që të mbledhen sa më lehtë provat e rastit të raportuar. Po ashtu rekomandohet që të ndahet buxhet për mirëmbajtje të platformës nga ana e Qeverisë, me qëllim të përmbushjes sa më të plotë të mandatit të grupit teknik.

16. Grupi teknik dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së platformës të krijohen kapacitetet e brendshme, për administrimin e platformës dhe të avancohet dhe përditësohet platforma, sipas nevojave të kërkesave të qytetarëve dhe komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

17. Me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së kësaj platforme edhe pas përfundimit të projektit Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit duhet të krijojë kapacitetet e brendshme për administrimin e platformës ose përmes hapjes së një pozite të re me detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të platformës apo edhe të bartë këto detyra dhe përgjegjësi në përshkrimin e punës së stafit ekzistues brenda saj.


SHTOJCA: PLATFORMA KOMBËTARE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN E PARAQITUR NË STATISTIKA

I. Rastet e raportuara sipas përkatësisë etnike




Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, 14 raportues të rastit janë deklaruar nga komuniteti Rom, 9 nga komuniteti Ashkali dhe 7 nga komuniteti Egjiptian. Në 9 raste raportuesit nuk e kanë deklaruar përkatësinë etnike.

II. Rastet e raportuara satusit të nivelit arsimimit




Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, marrë parasysh nivelin arsimor të raportuesit/es, 21 raportues të rasteve në platformë janë deklaruar që kanë të përfunduar universitetin, 6 që kanë të përfunduar arsimin e mesëm, 4 që kanë të përfunduar arsimin fillor, kurse 8 prej tyre në deklaram nuk e kanë përmendur fare nivelin e arsimimit të tyre.

III. Rastet e raportuara sipas statusit të punësimit




Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, marrë parasysh statusin e punësimit të raportuesve të rastit, 22 prej tyre kanë deklaruar që janë të punësuar, 10 janë të papunësuar, kurse 7 prej tyre nuk e kanë deklaruar fare statusin e punësimit të tyre.

IV. Rastet e raportuara sipas gjinisë




Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, marrë parasysh gjininë e raportuesve të rasteve, 16 prej tyre janë deklaruar raportues meshkuj, 14 femra kurse 9 prej tyre nuk e kanë deklaruar fare statusin gjinor.

V. Rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të raportuara sipas viteve ¹⁰⁴



Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, 7 raste janë të periudhës së viteve 2019-2020, të cilat janë raportuar pranë Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit dhe grupit teknik, përse të lansohet platforma, raste të cilat më vonë janë regjistruar në databazën e platformës. 11 raste janë raportuar përgjatë vitit 2022 kurse 21 raste janë raportuar gjatë vitit 2023.


VI. Rastet e raportuara sipas komunës ku ka ndodhur diskriminimi



Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, marrë parasysh komunën ku ka ndodhur rasti, del që komuna e Prishtinës ka përqindje më të lartë për nga vendi i diskriminimit dhe kjo ka ndodhur për shkak të përfshirjes në diskriminim të institucioneve qendrore që janë kryesisht në Prishtinë. Komuna tjetër me më shumë raste është ajo e Fushë Kosovës, e cila shquhet për një përqindje të lartë të banorëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Komuna e tretë me radhë është ajo e Obiliqit.


¹⁰⁴ Vetëm në periudhën gusht-nëntor 2023 janë raportuar 12 raste të reja. Shtatë (7) raste janë regjistruar dhe janë trajtuar nga Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të raportuara në Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit përse të lansohet platforma.

VII.Rastet e raportuara sipas statusit të trajtimit




Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, duke marrë parasysh statusin e trajtimit të tyre, nga platforma ose institucionet bie në sy numri i madh i 17 rasteve anonime të raportuara, në të cilat nuk dihet personi i diskriminuar dhe as kontakti i tij/saj por dhe nuk është paraqitur asnjë dëshmi që provon diskriminimin. 7 raste janë përfunduar nga platforma dhe për ato ka një vendim nga institucionet kompetente ndërsa 9 prej tyre janë në procedurë të trajtimit nga Institucionet. 2 raste janë në procedurë të trajtimit nga platforma, sepse janë dorëzuar së voni dhe janë duke u analizuar.

VIII.Rastet e raportuara sipas statusit të personit që ka raportuar rastin




Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, duke marrë parasysh se kush është raportues i raste, rezulton që 17 raste janë anonime, 8 janë raportuar nga palët e treta, kurse 13 prej tyre direkt nga palët e diskriminuara.

IX. Rastet e raportuara në platformë sipas subjektit ndaj të cilave zbatohet Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi



Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, duke marrë parasysh nenin 2.1 të LMD, rezulton që në 9 raste në diskriminim kanë qenë të përfshira institucionet qendrore, në 7 raste institucionet lokale, në 5 raste diskriminimin e kanë shkaktuar personat juridik të sektorit privat, kurse në 4 të tjera personat fizik të sektorit privat. Përnga efekti i nenit 2.1 të LMD 10 raste kanë qenë të pa përcaktuara.

X. Rastet e raportuara në platformës sipas autoritetit publik të përfshirë në diskriminimin



Përshkrimi: Nga 39 rastet e raportuara në platformë, duke u nisur nga autoriteti/institucioni i përfshirë në diskriminim, rezulton që 13 raste janë personat juridik ose fizik privat, në 4 raste MPB, në 3 raste Komuna e Obiliqit, kurse në dy raste Policia e Kosovës.



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.



Ndërtesa e Qeverisë,
Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit
Kati i 6-të, Zyra Nr. 602-607
Sheshi "Nene Terezë" p.n. 10.000
Prishtinë - Kosovë

www.raportodiskriminimin.org



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo